

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIREQENIES SOCIALE DHE RINISE
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

DIZENJIM MODE

Niveli V i KSHK
(Pas të mesmes)

Kodi: D1-V-14

Miratoi:

.....

**Ky skeletkurrikul u hartua me mbështetjen e Projektit IPA 2010 për
Zhvillimin e Burimeve Njerëzore, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar
nga Organizata Ndërkombëtare e Punës.**



Tiranë, 2014

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional pas të mesmes në profilin “Dizenjim mode”, niv. V i KSHK.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Dizenjim mode”, niveli V i KSHK.**
 - 1.Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “**Dizenjim mode**”, niveli V i KSHK.
 - 2.Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimimit në profilin “**Dizenjim mode**”, niveli V i KSHK.
 - 3.Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtijshëm në përfundim të arsimimit në profilin “**Dizenjim mode**”, niveli V i KSHK.
- III. Plani mësimor për profilin “Dizenjim mode”, niveli V i KSHK, me kohëzgjatje 2 vite mësimore**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin, provimet dhe certifikatën.**
- VII. Përshkruesit e moduleve profesionale.**

I. Qëllimet e arsimit profesional pas të mesmes në profilin “Dizenjim mode”, niveli V i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Dizenjim mode”, niveli V i KSHK, është *“të përgatisë krijues të kualifikuar në fushën e modës, të aftë për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me krijimin, prodhimin dhe konfeksionimin e veshjeve, si dhe të zhvillojë jo vetëm personalitetin krijues, por edhe personalitetin e tyre si qytetarë në përshtatje me mjedisin që i rrethon”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale në nivelin pas të mesëm, u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe krijuese, si dhe vlerat artistike dhe morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar nga pikëpamja artistike, psikologjike dhe fizike, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Dizenjim mode”, niveli V i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në profilin “Dizenjim mode”, niveli V i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “**Dizenjim mode**”, niveli V i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë ato/ata:

- Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore;
- Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm.
- Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin “Tekstil - konfeksione”.
- Individë që punojnë në industrinë e veshjes.
- Individë që janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- Individë që kanë aftësi të kufizuara, për të cilët institucioni arsimor krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MMSR përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimimit në profilin “Dizenjim mode”, niveli V i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional **“Dizenjim mode”**, niveli V i KSHK., nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të përdorë ngjyrën si një element të rëndësishëm të komunikimit në fushën e modës;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar dhe standardet në fuqi për aspekte të ndryshme në fushën e modës
- Të përdorë elementet e artit dhe dizajnit në mënyrë krijuese dhe inovatore;
- Të krijojë dizajnin e tekstileve si nëpërmjet mjeteve tradicionale ashtu edhe me ato dixhitale;
- Të përdorë teknologjinë në dizenjim mode në procesin e krijimit
- Të përdorë fotografinë, si një mjet i rëndësishëm i reklamimit të koleksionit
- Të përdorë mjetet e marketingut për reklama mediatike dhe prezantimin e produktit
- Të realizojë një projekt koleksioni në industrinë krijuese të modës;
- Të realizojë skemat e prerjes dhe paraqitjen grafike në mënyrë manuale dhe digjitale;
- Të krijojë linjat e veshjeve për fëmijë, femra dhe meshkuj;
- Të përdorë si elementet e historisë së modës ashtu edhe prirjet bashkëkohore në procesin e krijimit ;
- Të analizojë elemente të historisë së artit dhe estetikës;
- Të shpjegojë veshjen si element përfaqësues i identitetit individual dhe të grupit;
- Të ideojë dhe modelojë aksesore të ndryshëm;
- Të menaxhojë një biznes mode;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në dizenjim mode.

3. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimimit në profilin mësimor “Dizenjim mode”, niveli V i KSHK.

Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Dizenjim mode” e pajis nxënësin me certifikatën e dizenjuesit të modës, sipas nivelit V të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ky kualifikim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës si dizenjues mode në ndërmarrje të ndryshme të prodhimit të veshjeve, në punishte të ndryshme artizanale dhe atelie mode apo edhe të vetëpunësohet., etj.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit të mëtejshëm në arsimin e lartë, në degën “Inxhinieri tekstili dhe mode” (Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike) dhe degën “ Tekstil dhe modë” (Fakulteti i Arteve të Bukura).

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin “Dizenjim mode”, niveli V i KSHK, me kohëzgjatje 2 vite mësimore.

Plani mësimor për profilin mësimor “Dizenjim mode”, niveli V i KSHK.				
Nr	Kodi	Modulet mësimore	Orët vjetore	
			Viti I	Viti II
1	M-10-1069-14	Përdorimi i ngjyrave në dizenjim mode	72	-
2	M-10-1070-14	Realizimi i figurinës në modë nëpërmjet teknikave grafike	150	-
3	M-10-1071-14	Përdorimi i CAD/CAM në dizenjim mode	90	90
4	M-10-1072-14	Marketingu në fushën e modës	60	-
5	M-10-1073-14	Modelimi industrial dhe konfeksionimi	192	246
6	M-10-1074-14	Teknologjia e prodhimit të veshjeve	60	-
7	M-10-1075-14	Ideimi dhe modelimi i aksesoreve	66	114
8	M-10-1076-14	Histori arti dhe estetikë	60	-
9	M-10-1077-14	Projektimi i koleksionit	156	210
10	M-10-1078-14	Historia e modës	66	66
11	M-10-1079-14	Teknologji tekstili	90	-
12	M-10-1080-14	Rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në dizenjim mode	18	-
13	M-10-1081-14	Kuadri ligjor në fushën e modës	-	18
14	M-10-1082-14	Industria krijuese në fushën e modës	-	120
15	M-10-1083-14	Përdorimi i fotografisë në dizenjim mode	-	66
16	M-10-1084-14	Psikologjia sociale e veshjes	-	48
17	M-10-1085-14	Menaxhimi në biznesin e modës	-	42
		Gjithsej	36 javë (1080 orë)	34 javë (1020 orë)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor në arsimin profesional për “Dizenjim mode” në nivelin V i KSHK, pas të mesmes, zgjat 2 vite mësimore me një kohëzgjatje të përgjithshme 2100 orë mësimore (36 javë x 5 ditë/javë x 6 orë/ditë = 1080 orë mësimore vitin e I dhe 34 javë x 5 ditë/javë x 6 orë/ditë = 1020 orë mësimore në vitin e II). Në përfundim të vitit të II janë parashikuar dy javë për provimet përfundimtare.

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Dizenjim mode”, niveli V i KSHK, përbëhet nga modulet profesionale teoriko-praktike (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

Renditja e realizimit të moduleve bëhet nga vetë shkolla, duke konsideruar parimet didaktike bazë (nga më e thjeshta te më e ndërlikuara, nga niveli i ulët te më i larti, nga teoria te praktika, etj.), si dhe kushte konkrete të shkollës. Për të rritur eficiencën e procesit mësimor, mund të realizohen paralelisht dy ose më shumë module, si dhe mund të zbatohet ndarja në grupe e nxënësve.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e moduleve profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e moduleve profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të teorisë me praktikën në to, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Dizenjim mode”, niveli V i KSHK.

Mësuesit duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës dhe punës. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimi (teorik dhe praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilin profesional “Dizenjim mode”, niveli V i KSHK.

VI. Udhëzime për vlerësimin, provimet dhe certifikatën.

Vlerësimi vjetor i nxënësve për modulet profesionale bëhet nga vetë mësuesit përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) për modulet teoriko-praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të arsimimit për “Dizenjim mode”, niveli V i KSHK, pas të mesëm, nxënësit i nënshtrohen provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi teorik profesional (test me shkrim)
- b) Provimi praktik profesional (realizimi i një detyre praktike dhe realizimi i një projekti artistik).

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohuri, shprehje, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale të profilit “Dizenjim mode”.

Me përfundimin e sukseshëm të shkollimit, nxënësit marrin Certifikatën e aftësisë profesionale, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MMSR, kjo dëshmi përmban:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet (notat) e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare.

VII. Përshkruesit e moduleve profesionale

1. Moduli “Përdorimi i ngjyrave në dizenjim mode”

Profili: Dizenjim mode

Niveli: V i KSHK

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRDORIMI I NGJYRAVE NË DIZENJIM MODE	M-10-1069-14
Qëllimi i modulit	Një modul teorik-praktik që i njeh nxënësit me teorinë e ngjyrave, si dhe i aftëson ata që t’i zbatojnë këto njohuri gjatë veprimtarisë krijuese në dizenjimin e koleksionit në biznesin e modës.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	– Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; – Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm. – Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin “Tekstil - konfeksione”. – Individë që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe punojnë në industrinë e veshjes. Individë që janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe janë të aftë të tregojnë aftësi të nivelit IV të KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan funksionin e ngjyrave në modë Përmbajtja: - Zbërthimi i dritës në spektrin e ngjyrave - Shpjegimi i ngjyrave parësore (primare) - Realizimi i ngjyrave dytësore (sekondare) nëpërmjet përzierjes së ngjyrave parësore (primare) - Përshkrimi i masës, peshës, tonalitetit dhe intensitetit të ngjyrave - Analiza dhe eksperimentimi i kontrasteve të ngjyrave - Përshkrimi dhe krijimi i kartelës së ngjyrave. Instrumentat e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim - Vëzhgim me listë kontrolli Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë saktë zbërthimin e dritës në spektrin e ngjyrave; - të shpjegojë ngjyrat parësore (primare); - të realizojë ngjyrat dytësore (sekondare) nëpërmjet përzierjes së ngjyrave parësore (primare); - të përshkruajë saktë masën, peshën, tonalitetin dhe	

-
- intensitetin e ngjyrave;
 - të analizojë dhe eksperimentojë llojet e kontrasteve të ngjyrave;
 - të përshkruajë dhe krijojë kartelën e ngjyrave.

RM 2 Nxënësi përshkruan harmoninë e kombinimit të ngjyrave midis tyre dhe lidhjen midis formës dhe ngjyrës.

Përmbajtja:

- Krijimi i akordeve të ngjyrave midis dy, tre, katër ose më shumë tonalitetes;
- Shoqërimi i ngjyrës me formën përkatëse
- Përdorimi i shoqërizimit të formës me ngjyrën në krijimet në fushën e modës
- Shpjegimi i efekteve hapësinore të ngjyrave

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë akordet midis dy, tre, katër ose më shumë ngjyrash;
- të përshkruajë shoqërizimin e ngjyrës me formën përkatëse;
- të përdorë shoqërizimin e ngjyrës me formën përkatëse në krijimet në fushën e modës;
- të shpjegojë efektet hapësinore të ngjyrave.

RM 3 Nxënësi përshkruan komunikimin nëpërmjet ngjyrave (impresionin dhe ekspresionin).

Përmbajtja:

- Përshkrimi i efekteve të ngjyrave në natyrë;
- Interpretimi i ngjyrave;
- Përshkrimi i karakteristikave dhe shprehshmërisë së ngjyrave;
- Kompozimi me ngjyra;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë efektet e ngjyrave në natyrë;
- të interpretojë ngjyrat në krijimet e ti;
- të përshkruajë karakteristikat dhe shprehshmërinë e ngjyrave;
- të zbatojë kriteret kompozicionale të ngjyrës në veshje dhe në koleksion

RM 4 Nxënësi përshkruan psikologjinë e ngjyrave dhe aplikimet e saj.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i domethënies kulturore të ngjyrave dhe

simbolizmi

- Analiza psiko-kromatike e ngjyrës në reklamë
- Përdorimi i efekteve psikologjike të ngjyrës në dizajn

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruaj domethënien që merr ngjyra në kultura të ndryshme dhe simbolikën e saj
- të analizojë rëndësinë e ngjyrës në suksesin e reklamës
- të shpjegojë përdorimin e efekteve psikologjike të ngjyrës në modë dhe dizajn

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të zhvillohet në klasë.
- Mësuesi duhet të zbatojë sa më shumë shembuj dhe demonstrime të përdorimit të sukseshëm të ngjyrave në koleksione të ndryshme të modës.
- Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në diskutimet në lidhje me konceptet dhe mënyrat e shumta të përdorimit të ngjyrës si një element mjaft të rëndësishëm për të siguruar suksesin e koleksionit.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të synohet më tepër në verifikimin e koncepteve dhe shkallës së aftësive praktike që ata kanë fituar për të përdorur ngjyrën në krijimet e tyre.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga Nxënësi i të gjitha kriterëve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimi, të pasjisur si më poshtë:

- Klasë mësimore.
 - Postera ilustrues.
 - Kompjuter dhe projektor.
 - Mjete artistike si, letra, penela, tempera.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul
-

2. Moduli “Realizimi i figurinës në modë nëpërmjet teknikave grafike “

Profili: Dizenjim mode

Niveli: V i KSHK

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	REALIZIMI I FIGURINËS NË MODË NËPËRMJET TEKNIKAVE GRAFIKE	M-10-1070-14
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i njeh nxënësit me konceptet bazë të vizatimit të figurinës së modës dhe teknikave grafike të realizimit të saj, si dhe i aftëson ata për të zbatuar këto koncepte e për të dizenjuar koleksionin e tyre në biznesin e modës.	
Kohëzgjatja e modulit	150 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	– Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; – Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm. – Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin “Tekstil - konfeksione”. – Individë që punojnë në industrinë e veshjes. Individë që janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe janë të aftë të tregojnë aftësi të nivelit 4.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi zbaton rregullat e vizatimit të figurinës së modës - Përshkrimi i kanoneve historike të proporcioneve të trupit të njeriut - Përshkrimi i kanonit të modës dhe parimet e perspektivës; - Ndërtimi i manekinit; - Vizatimi i portretit (sytë, hunda, veshët, koka) - Vizatimi i portretit dhe modelet e flokëve. - Vizatimi me volum i portretit. - Vizatimi i dorës, krahut, këmbës, bustit. - Përdorimi i hapësirës pozitive dhe negative në ndërtimin e figurës së modës; - Drejtimi i palave në figurën e veshur. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgimi i realizimit të figurinës së modës; - Vëzhgimi i përdorimit të teknikave grafike në realizimin e figurinës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të shpjegojë kanonet historike të proporcioneve të trupit të njeriut; - të shpjegojë kanonin e modës dhe të paraqesë paraqesë figurinën në tre pika shikimi; - të vizatojë manekiniën në poza statike dhe dinamike;	

-
- të vizatojë elementët e portretit sytë, hundën, gojën, veshët;
 - të vizatojë portretin me proporcione të sakta;
 - të vizatojë portretin me modele të ndryshme të krehjes dhe me kapele;
 - të vizatojë portretin me volum nëpërmjet dritë hijes;
 - të vizatojë pjesët e tjera të figurinës si dorën, krahun, këmbën, bustin;
 - të përdorë hapësirë pozitive dhe negative në ndërtimin e figurinës së modës, si në pozicionin statik edhe në atë dinamik;
 - Të ndjekë drejtimin që marrin palat e veshjeve në trupin e figurinës.

RM 2 Nxënësi përdor figurinën e modës për të shprehur krijimet e veta.

Përmbajtja:

- Vizatimi i figurinës së modës;
- Vizatimi i modeleve në pasarelë sipas një koreografie;
- Stilizimi i figurinës së modës;
- Dallimi midis Figurinës teknike dhe figurinës për ilustrim;
- Analiza e planeve të ndryshme fotografike;
- Vizatimi i pozicioneve më të rëndësishme të figurinës së modës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgimi i realizimit të figurinës së modës;
- Vëzhgimi i përdorimit të teknikave grafike në realizimin e figurinës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vizatojë figurinën e modës;
- të paraqesë koreografinë e modeleve në pasarelë nëpërmjet vizatimit;
- të stilizojë figurinën e modës;
- të dallojë figurinën teknike nga figurina për ilustrim;
- të analizojë plane të ndryshme fotografike të figurinës në modë;
- të vizatojë pozicionet më të rëndësishme të figurinës së modës.

RM 3 Nxënësi përdor teknikat grafike dhe piktorike në krijimin e modeleve të veshjeve mbi figurinën e modës.

Përmbajtja:

- përdorimi i teknikave grafike të bardhë e zisë;
- Përdorimi i teknikave të ngjyrës: akuarelet, lapasat akuarele, lapustilat, pastelat, markerat;
- Përdorimi i teknikës së kolazhit;
- Përdorimi i teknikave të përziera;
- Përdorimi i teknikave të ndryshme për dizenjimin e tekstileve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgimi i realizimit të figurinës së modës;
- Vëzhgimi i përdorimit të teknikave grafike në realizimin e figurinës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë teknikat grafike të bardhë e zisë në krijimin e modeleve të veshjeve;
- të përdorë teknikat e ngjyrave të tilla si akuarelet, lapsat akuarele, lapustilat, pastelat, markerat, në krijimin e modeleve të veshjeve;
- të përdorë teknikën e kolazhit në krijimin e modeleve të veshjeve;
- të përdorë teknikat e përziera në krijimin e modeleve të veshjeve;
- të përdorë teknika të ndryshme në dizenjimin e tekstileve.

RM 4 Nxënësi përdor elementët artistikë në krijimin e modeleve të veshjeve mbi figurinën e modës.**Përmbajtja:**

- Perceptimi i shenjës;
- Përdorimi i figurave gjeometrike bazë rrethit, kuadratisht, trekëndëshit, për ndërtimin e figurinës së modës ashtu edhe të veshjes;
- Përdorimi i iluzionit optik për të krijuar në fushën e modës;
- Perceptimi i lëvizjes dhe i hapësirës;
- Krijimi i ekuilibrit midis lëvizjes së figurinës dhe veshjes, dhe në ndërtimin kompozicional të veshjes;
- Krijimi i veshjeve simetrike dhe asimetrike;
- Praqitja grafike e teksturës në tekstin e veshjes;
- Përshkrimi i lidhjes midis modës dhe interiorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgimi i realizimit të figurinës së modës;
- Vëzhgimi i përdorimit të teknikave grafike në realizimin e figurinës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të perceptojë shenjën artistike si një element i rëndësishëm në krijimtarinë në fushën e modës.
- të përdorë format gjeometrike bazë si për ndërtimin e figurinës së modës ashtu edhe të veshjes;
- të përdorë efektet e iluzionit optik për të krijuar në fushën e modës;
- të perceptojë lëvizjen e figurinës së modës brenda hapësirës së duhur;
- të krijojnë ekuilibër midis lëvizjes së figurinës dhe veshjes, dhe në ndërtimin kompozicional të veshjes;
- të krijojnë veshje simetrike dhe asimetrike duke ruajtur ekuilibrin kompozicional;

- të paraqesë grafikisht teksturën e tekstilit të veshjes;
- të shpjegojë lidhjen midis modës dhe interiorit.

RM5 Nxënësi realizon vizatimin teknik të veshjeve si pjesë e procesit të punës në industrinë e veshjes.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i volumeve dhe linjave bazë në veshje;
- Ndërtimi i bustit manekinë dhe pençat;
- Interpretimi i lirshmërisë së veshjes në vizatim;
- Përshkrimi i ndikimit të prerjes në linjën e veshjeve;
- Vizatimi në plan dhe skeda teknike;
- Vizatimi i elementëve estetikë të veshjes (rifiniturat)(palat, xhepat, etj);
- Vizatimi teknik i fundit;
- Vizatimi teknik i veshjve bazë;
- Vizatimi teknik i mëngëve bazë;
- Vizatimi teknik i manshetave (triko, bluza e kemisha)
- Vizatimi teknik i llojeve të ndryshme të jakave dhe dekolteve;
- Vizatimi teknik i kapuçave;
- Vizatimi teknik i pantallonave;
- Vizatimi teknik i xhaketave dhe jelekëve;
- Vizatimi teknik i xhaketave sportive dhe xhupave;
- Vizatimi teknik i jakave dhe detajeve sportive;
- Vizatimi teknik i palltove, pardesyve, pelerinave;
- Vizatimi teknik i veshjeve sportive;
- Shpjegimet për librin e projektit;
- Vizatimi teknik i aksesorëve;
- Vizatimi teknik i këpucëve, çizmeve, sandaleve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgimi i realizimit të figurinës së modës;
- Vëzhgimi i përdorimit të teknikave grafike në realizimin e figurinës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë volumet dhe linjat bazë në veshje;
- të ndërtijë bustin manekinë dhe pençat;
- të interpretojë lirshmërinë e veshjes në krijimet e veta duke respektuar materialin tekstil të ideuar;
- të përshkruajë se si prerja ndikon në linjën e veshjeve;
- të përshkruajë vizatimin në plan dhe të realizojë skedën teknike;
- të vizatojë teknikisht elementët estetikë të veshjes (rifiniturat)(palat, xhepat, etj)
- të realizojë skicën teknike të modeleve të ndryshme të fundit;
- të realizojë skicën teknike të veshjve bazë;
- të realizojë skicën teknike të mëngëve bazë;
- të realizojë skicën teknike të manshetave (triko, bluza e kemisha)

- të realizojë skicën teknike të llojeve të ndryshme të jakave dhe dekolteve;
- të realizojë skicën teknike të kapuçave;
- të realizojë skicën teknike të pantallonave;
- të realizojë skicën teknike të xhaketa dhe jelekëve;
- të realizojë skicën teknike të xhaketa sportive dhe xhupave;
- të realizojë skicën teknike të jakave dhe detajeve sportive;
- të realizojë skicën teknike të palltove, pardesyeve, pelerinave;
- të realizojë skicën teknike të veshjeve sportive;
- të realizojë shpjegimet për librin e projektit;
- të realizojë skicën teknike të aksesorëve;
- të realizojë skicën teknike të këpucëve, çizmeve, sandaleve;

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të zhvillohet në klasë.
- Mësuesi duhet të japë sa më shumë shembuj dhe ilustrime të figurinës së modës dhe të teknikave grafike, duke i lidhur ato me aspektet e punës konkrete të dizenjuesit të modës në biznesin e modës.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në diskutimet në lidhje me mundësitë shprehëse të mjeteve dhe teknikave të ndryshme.
- Mësuesi duhet të japë si detyra në klasë, ashtu edhe detyra shtëpie në lidhje me rritjen e aftësive vizatimore dhe krijuese të nxënësve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të synohet më tepër në verifikimin e shkallës së aftësive praktike që ata kanë fituar për të realizuar figurinën nëpërmjet teknikëve grafike dhe aspektit të tyre krijues.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga Nxënësi i të gjitha kriterëve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimin, të pasjisur si më poshtë:
- Klasë mësimore.
 - Dërrasë e zezë.
 - Kompjuter, printer.
 - Projektor mësimor.
 - Tabela dhe pankarta ilustruese.
 - Materiale pune si lapsa, letra, bojta, etj.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli "Përdorimi i CAD/CAM në dizenjim mode"

Drejtimi: Dizenjim mode

Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRDORIMI I CAD/CAM NË DIZENJIM MODE	M-10-1071-14
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë për të përdorur teknologjinë dhe programet kompjuterike në realizimin e figurinave, modelit të veshjeve, skedës teknike dhe teknikës së prerjes.	
Kohëzgjatja e modulit	180 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; - Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm. - Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin "Tekstil - konfeksione". - Individë që punojnë në industrinë e veshjes. Individë që janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe janë të aftë të tregojnë aftësi të nivelit 4.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan teknologjinë në modë. Përmbajtja: - Përcaktimi i nevojës në përdorimin e teknologjisë CAD/CAM. - Analizimi mbi zhvillimin e teknologjisë dhe fushat e zbatimit të saj në industrinë e modës. - Përcaktimi i implementimit CAD/CAM në industrinë e modës. - Programet kompjuterike bazë për realizimin e figurinës, skicës, modelit të veshjes dhe skedës teknike. - Karakteristikat dhe rastet e përdorimit të programit Kaledo Style. - Karakteristikat dhe rastet e përdorimit të programit Photoshop dhe Corel Draë. - Procedura e realizimit të stampimeve serigrafike me programet kompjuterike. - Realizimi i skedës teknike përmes programeve kompjuterike Instrumentat e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Test me shkrim Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë zhvillimin e teknologjisë dhe fushat e	

-
- zbatimit të saj në industrinë e modës
 - të përshkruajë programet kompjuterike bazë për realizimin e figurines, skicës dhe modelit të veshjes.
 - të listojë dhe shpjegojë karakteristikat dhe rastet e përdorimit të programit Kaledo Style
 - të listojë dhe karakteristikat dhe rastet e përdorimit të programit Photoshop dhe Corel Draë.
 - të përshkruajë saktë opsionet dhe komandat e realizimit të stampimeve serigrafike me programet kompjuterike.
 - të përshkruajë realizimin e skedës teknike përmes programeve kompjuterike.

RM 2 Nxënësi përdor programin Kaledo Style në dizajnim mode.
Përmbajtja:

- Prezantimi i dritares së punës dhe mënyra e përdorimit të programit Kaledo Style.
- Importimi i figurinës nga libraria e Kaledo Style në ndihmë të vizatimit të skicës
- Realizimi i figurinës me programin Kaledo Style
- Vizatimi i modelit të veshjes me anë të veglave të vizatimit me programin Kaledo Style.
- Modifikimi i modelit të veshjes me anë të veglave të manipulimit me Kaledo Style.
- Përzgjedhja e ngjyrave palate dhe kodit pantone për realizimin e koleksionin me Kaledo Style.
- Realizimi i dizajnit të tekstilit (methurje/endje, me stampim) me Kaledo Style.
- Përzgjedhja e aksesorëve të gatshëm për përfundimin e modelit të veshjes në librarinë e Kaledo Style.
- Realizimi i modelit të veshjes me programin Kaledo Style.
- Realizimi i një mini koleksioni me programin Kaledo Style.
- Realizimi i skedës teknike me programin .

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë saktë mënyrën e organizimit të dritares së punës dhe përdorimin e programit Kaledo Style.
- të shpjegojë veglat e vizatimit dhe manipulimit të skicës dhe imazheve në Kaledo Style.
- të tregojë hapat për importimin dhe realizimin e figurinës në Kaledo Style.
- të realizojë modelin e veshjes me programin Kaledo Style.
- të realizojë me saktësi skedën teknike me programin Kaledo Style.

RM 3 Nxënësi përdor programin Adobe photoshop dhe Corel Draw në dizajnim mode.

Përmbajtja:

- Prezantimi i dritares së punës dhe mënyra e përdorimit të programit Adobe photoshop.
- Shpjegimi i komandave dhe veglave të ndërtimit dhe manipulimit me Adobe Photoshop.
- Përpunimi i fotove apo imazheve tekstile në Adobe Photoshop.
- Eksportimi i imazheve, fotove në programin Corel Draw.
- Leximi i figurinës, skicës, imazheve dhe fotove të përpunuara me Corel Draw.
- Realizimi i figurinës me programin Corel Draw.
- Vizatimi i modelit të veshjes me anë të veglave të vizatimit në programin Corel Draw.
- Modifikimi i modelit të veshjes me anë të veglave të manipulimit në Corel Draw.
- Realizimi i modelit të veshjes me programin Corel Draw.
- Realizimi i një mini koleksioni me Corel Draw.
- Realizimi i skedës teknike me programin Corel Draw

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë saktë mënyrën e organizimit të dritares së punës dhe përdorimin e programit Adobe Photoshop dhe Corel Draw.
- të përpunojë foto apo imazhe të tekstileve me Adobe Photoshop.
- të eksportojë imazhet apo fotot e përpunuara në programin Corel Draw.
- të shpjegojë veglat e vizatimit dhe manipulimit të skicës
- të tregojë hapat për importimin dhe realizimin e figurinës në Corel Draw.
- të realizojë modelin e veshjes me programin Corel Draw.
- të realizojë me saktësi skedën teknike me programin Corel Draw.

RM 4 Nxënësi përdor programin CATD-Lectra Modaris për ndërtimin e bazave të veshjeve, modifikimin e kallëpeve bazë për realizimin e modeleve të ndryshme, industrializimin e kallëpeve të modeleve, zhvillimin e masave bazuar në kallëpet bazë dhe ekonomizimin e dyshekut me Lectra Diamino.

Përmbajtja:

- Prezantimi i dritares kryesore të Lectra Modaris.
- Shpjegimi i i përdorimit të komandave për ndërtimin e kallëpeve.
- Zbatimi i komandave dhe funksioneve për ndërtimin e kallëpit bazë të fundit, bluzës, pantallonave këmbësore, veshjeve për mbrëmje, të një kostumi për meshkuj, etj.
- Shpjegimi i përdorimit të komandave për modifikimin e

kallëpeve.

- Përdorimi i komandave për modifikimin e kallëpit bazë të fundit, bluzës, pantallonave, këmishës, etj.
- Shpjegimi i përdorimit të komandave të industrializimit të kallëpeve.
- Përdorimi i komandave për industrializimin e kallëpit bazë të fundit, bluzës, pantallonave, këmishës etj.
- Shpjegimi i mënyrës së krijimit të tabelave të masave.
- Realizimi i një table masash numerike dhe importimi i tyre në faqen e punës.
- Realizimi i një table masash alfa numerike dhe importimi i tyre në faqen e punës.
- Shpjegimi i përdorimit të komandave për zhvillimin e masave.
- Përdorimi i komandave për zhvillimin e masave të kallëpit të fundit, pantallonave, bluzës etj sipas metodës italiane
- Përdorimi i komandave për finalizimin e modeleve.
- Zbatimi i komandave për krijimin e varianteve të veshjeve, eksportimi dhe printimi i tyre.
- Zbatimi i komandave për printimin e modeleve me Vigiprint të ndërtuara në Lectra Modaris.
- Përdorimi i komandave të ekonomizimit të prerjes në Lectra Diamino.
- Realizimi i skedarëve të vendosjes dhe realizimi i shtrirjes me ndihmën e e përdorimit të komandave.
- Realizimi i një shtrimi duke u nisur nga një shtrim ekzistues me ndihmën e e përdorimit të komandave.
- Realizimi i shtrimit automatik me ndihmën e e përdorimit të komandave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë dhe prezantojë saktë dritaren e punës dhe mënyrën e përorimit të programit Lectra Modaris.
- të tregojë çfarë përmbajnë funksionet nga F1- F8.
- të zbatojë komandat në funksionin F1- F2 për ndërtimin e kallëpeve.
- të përdorë komandat në funksionin F3 për modifikimin e kallëpeve bazë për kalim në modele të tjera.
- të përdorë komandat e funksionit F4 për industrializimin e detaleve të veshjes.
- të zbatojë komandat për modifikime të mëtejshme të kallëpeve dhe zhvillimin e masave.
- të përdorë komandat për krijimin e variantit dhe eksportimin e tij në Lectra Diamino.
- të përdorë komandat për ekonomizimin e shtrimit të dyshekut në Lectra Diamino.
- të realizojë printimin e një dysheku.

RM 5 Nxënësi përdor programin kompjuterik PDS (Pattern Design System) për ndërtimin e kallëpeve bazë, modifikimin e kallëpeve bazë për realizimin e modeleve të ndryshme, industrializimin e tyre, zhvillimin e masave dhe ekonomizimin e dyshekut me Optitex Markers.

Përmbajtja:

- Prezantimi i dritares kryesore të OptiTex.
- Shpjegimi i i përdorimit të komandave për ndërtimin e kallëpeve.
- Zbatimi i komandave dhe funksioneve për ndërtimin e kallëpit bazë të fundit, bluzës, pantallonave këmishës, veshjeve për mbrëmje, kostum për meshkuj, etj.
- Shpjegimi i përdorimit të komandave për modifikimin e kallëpeve.
- Përdorimi i komandave për modifikimin e kallëpit bazë të fundit, bluzës, pantallonave, këmishës, etj.
- Shpjegimi i përdorimit të komandave të industrializimit të kallëpeve.
- Përdorimi i komandave për industrializimin e kallëpit bazë të fundit, bluzës, pantallonave, këmishës etj.
- Shpjegimi i mënyrës së krijimit të tabelave të masave.
- Realizimi i një table masash numerike dhe importimi i tyre në faqen e punës.
- Realizimi i një table masash alfa numerike dhe importimi i tyre në faqen e punës.
- Shpjegimi i përdorimit të komandave për zhvillim masash
- Përdorimi i komandave për zhvillimin e masave të kallëpit të fundit, pantallonave, bluzës etj sipas metodës italiane.
- Përdorimi i komandave për finalizimin e modeleve.
- Zbatimi i komandave për krijimin e varianteve të veshjeve, eksportimi dhe printimi i tyre.
- Zbatimi i komandave për printimin e modeleve me Vigiprint të ndërtuara në OptiTex.
- Përdorimi i komandave të ekonomizimit të prerjes në Optitex Markers.
- Realizimi i skedarëve të vendosjes dhe realizimi i shtrirjes me ndihmën e e përdorimit të komandave.
- Realizimi i një shtrimi duke u nisur nga një shtrim ekzistues me ndihmën e e përdorimit të komandave.
- Realizimi i shtrimit automatik me ndihmën e e përdorimit të komandave.
- Zbatimi i komandave për importimin dhe eksportimin i file-ve CAD/CA.
- Përdorimi i komandave për importimin e file-ve në Marker.
- Përdorimi i komandave për eksportimin e file-ve në file të tjera CAD/CAM.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë dhe prezantojë saktë dritaren e punës dhe mënyrën e përorimit të programit Optitex.
- të tregojë çfarë përmbajnë funksionet.
- të zbatojë komandat për ndërtimin e kallëpeve.
- të përdorë komandat për modifikimin e kallëpeve bazë për kalim në modele të tjera.
- të përdorë komandat për industrializimin e detaleve të veshjes.
- të zbatojë komandat për modifikime të mëtejshme të kallëpeve dhe zhvillimin e masave.
- të përdorë komandat për krijimin e variantit dhe eksportimin e tij në Optitex Markers.
- të përdorë komandat për ekonomizimin e shtrimit të dyshekut në Optitex Markers.
- të realizojë printimin e një dysheku.
- të eksportojë dhe importojë file të tjera CAD/CAM.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin e informatikës për dizenjues mode të pajisur me kompiutera dhe internet si dhe mjetet përkatëse për kryerjen e kësaj veprimtarie.
- Rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë veprimtari në fushën dizenjimi mode.
- Mësimdhënësi duhet të kryejë demonstrime konkrete të përdorimit të programeve kompjuterike në dizenjimi mode.
- Nxënëset duhet të angazhohen në veprimtari konkrete, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të Nxënësit duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e figurave, skicave me programet përkatëse kompjuterike.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit..

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Kabineti i kompjuterave në profilin dizenjues mode.
 - Kompjuter, printer, fotokopje, shërbim interneti dhe programe kompjuterike për të realizuar përmbajtjen e modulit.
 - Ploter.
 - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Bashkëpunim me biznese që realizojnë veprimtari në fushën e modës.
-

4. Moduli "Marketingu në fushën e modës"

Profili: Dizenjim Mode
Niveli: V i KSHK

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	MARKETINGU NË FUSHËN E MODËS	M-10-1072-14
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko- praktik që i jep nxënësit informacionin e nevojshëm mbi marketingun, tregun, konkurrencën si dhe zbatimin e një plani marketing.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	– Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; – Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm. – Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin “Tekstil - konfeksione”. – Individë që janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe janë të aftë të tregojnë aftësi të nivelit 4.	
8.Moduli “Histori arti dhe estetikë”

Profili: Dizenjim mode

Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HISTORI ARTI DHE ESTETIKË	M-10-1076-14
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i njeh nxënësit me konceptet bazë të estetikës dhe me zhvillimin e artit pamor (botëror dhe shqiptar), në kontekstin historik, social - kulturor, si edhe i aftëson në përdorimin e këtyre njohurive në krijimtarinë e tyre në fushën e modës.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; - Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm. - Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin “Tekstil - konfeksione”. - Individë që janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe janë të aftë të tregojnë aftësi të nivelit 4.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan objektin e estetikës dhe veçoritë e saj. Përmbajtja: - Shpjegimi i objektit të estetikës dhe veçorive të saj si shkencë filozofike. - Shpjegimi i karakterit real të “së bukurës” në një vepër dhe objekt arti. - Përshkrimi i ndryshimit të shijeve estetike sipas periudhave historike. - Vlerësimi i rëndësisë së <i>përmbajtjes</i> dhe <i>formës</i> në art. - Klasifikimi i arteve sipas mjeteve shprehëse. - Shpjegimi i arteve me strukturë të thjeshtë dhe të përbërë. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të shpjegojë objektin e estetikës dhe veçoritë e saj si shkencë filozofike. - të shpjegojë karakterin real të së bukurës në një vepër dhe objekt arti. - të përshkruajë se si shijet estetike ndryshojnë sipas periudhave historike. - të vlerësojë rëndësinë e <i>përmbajtjes</i> dhe <i>formës</i> në art. - të bëjë klasifikimin e arteve sipas mjeteve shprehëse. - të shpjegojë artet me strukturë të thjeshtë dhe të	

RM 2 Nxënësi përshkruan zhvillimet dhe karakteristikat e artit pamor të periudhës së antikitetit dhe mesjetës.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i karakteriatikave të artit prehistorik;
- Përshkrimi i karakteriatikave të artit në Mesopotami dhe atij egjiptian
- Përshkrimi i karakteriatikave të artit grek dhe romak;
- Përshkrimi i karakteriatikave të artit në mesjetë (kristianizmi i hershëm, arti bizantin, arti romanik, arti gotik);
- Përshkrimi i karakteristikave të qyteteve antike në Shqipëri;
- Përshkrimi i karakteristikave të artit bizantin në Shqipëri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë karakteriatikat e artit prehistorik;
- të përshkruajë karakteriatikat e artit në Mesopotami dhe artit egjiptian,
- të përshkruajë karakteriatikat e artit grek dhe romak;
- të përshkruajë karakteriatikat e artit në mesjetë: kristjanizmi i hershëm, arti bizantin, arti romanik, arti gotik.
- të përshkruajë karakteriatikat e qyteteve antike në Shqipëri;
- të përshkruajë karakteriatikat e artit bizantin në Shqipëri.

RM 3 Nxënësi përshkruan karakteristikat e artit të periudhës së Rilindjes dhe të traditave artistike në Lindje.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i karakteristikave të artit në periudhën e Rilindjes italiane
- Përshkrimi i karakteristikave të artit të Rilindjes në Europën veriore.
- Përshkrimi i karakteristikave të artit dhe traditave në Lindje, Amerikën latine dhe Afrikë.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë karakteriatikat e artit në periudhën e Rilindjes italiane
- të përshkruajë karakteriatikat e artit të Rilindjes në Europën veriore.
- të përshkruajë karakteristikat e artit dhe traditave në Lindje,

Amerikën latine dhe Afrikë.

RM 4 Nxënësi përshkruan zhvillimet dhe karakteristikat e artit pamor të periudhës që nga Artit Barok deri te postimpresionizmi.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i karakteristikave të artit në periudhën baroke;
- Përshkrimi i karakteristikave të artit në periudhën rokoko;
- Përshkrimi i karakteristikave të artit në periudhën neoklasike dhe autorët kryesorë;
- Përshkrimi i karakteristikave të artit në periudhën romantike dhe autorët kryesorë;
- Përshkrimi i karakteristikave të artit në periudhën realiste dhe autorët kryesorë;
- Përshkrimi i karakteristikave të Impresionizmit dhe autorët kryesorë;
- Përshkrimi i karakteristikave të Postimpresionizmit dhe autorët kryesorë.
- Përshkrimi i karakteristikave të artit shqiptar në periudhën e pavarësisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë karakteristikat e artit në periudhën baroke;
- të përshkruajë karakteristikat e artit në periudhën rokoko;
- të përshkruajë karakteristikat e artit në periudhën Neoklasike dhe autorët kryesorë;
- të përshkruajë karakteristikat e artit në periudhën romantike dhe autorët kryesorë;
- të përshkruajë karakteristikat e artit në periudhën realiste dhe autorët kryesorë;
- të përshkruajë karakteristikat e impresionizmit dhe autorët kryesorë;
- të përshkruajë karakteristikat e postimpresionizmit dhe autorët kryesorë.
- të përshkruajë karakteristikat e artit shqiptar në periudhën e pavarësisë.

RM 5 Nxënësi përshkruan zhvillimet dhe karakteristikat e artit pamor në shekullin XX dhe drejtimet e reja bashkëkohore.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i karakteristikave të avangardave artistike: (fovizmi, ekspresionizmi, kubizmi dhe abstraksionizmi)
- Përshkrimi i rëndësisë që pati shkolla e Bauhaus në zhvillimin e artit, arkitekturës dhe dizajnit bashkohor
- Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme të

- arkitekturës dhe të përfaqësuesve të saj në këtë periudhë;
- Përshkrimi i karakteristikave kryesore të lëvizjeve artistike të shek.XX (dadaizmi, surrealizmi, ekspresionizmi abstrakt, pop art, arti konceptual, etj);
- Përshkrimi i karakteristikave të artit pamor në Shqipëri mbas luftës së dytë botërore

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë karakteriatikat e avangardave artistike (fovizmi, ekspresionizmi, kubizmi dhe abstraksionizmi;
- të përshkruajë rëndësinë e madhe që pati shkolla e Bauhaus në zhvillimin e artit bashkohor, arkitekturës dhe dizajnit.
- të përshkruajë karakteriatikat e përgjithshme të arkitekturës dhe të përfaqësuesve në këtë periudhë;
- të përshkruajë karakteriatikat kryesore të lëvizjeve artistike të shek.XX (dadaizmi, surrealizmi, ekspresionizmi abstrakt, pop art, arti konceptual, etj;
- të përshkruajë karakteriatikat e artit pamor në Shqipëri mbas luftës së dytë botërore

Udhëzime për zbatimin e modulit	– Ky modul duhet të trajtohet në klasë. – Lекtori duhet të zhvillojë leksionet duke përdorur sa më shumë materiale ilustruese e fotografike mbi veprat e artit dhe arkitekturës. – Nxënësi duhet të angazhohet në punën kërkimore të gjetjes së materialeve shtesë mbi historinë e artit duke i parë si një nxitjedhe burim informacioni për veprimtarinë e ti krijuese në fushën e modës. – Gjatë vlerësimit të nxënësve, të vihet theksi në analizën e karakteristikave të periudhave të ndryshme historike.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Realizimi i këtij moduli mundësohet në ambjentet e klasës. Për realizimin me sukses të këtij moduli janë të rëndësishme: - Kompjuteri dhe projektori. - Leksione, fotografi dhe materiale të tjera ilustruese, katalogë, në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

9. Moduli "Projektimi i koleksionit"

Profili: Dizenjim mode

Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PROJEKTIMI I KOLEKSIONIT	M-10-1077-14
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i njeh nxënësit me konceptet bazë të krijimit dhe realizimit hap pas hapi të koleksionit të modës, si dhe i aftëson ata për të zbatuar këto koncepte në projektimin e koleksionit në biznesin e modës.	
Kohëzgjatja e modulit	366 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	– Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; – Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm. – Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin "Tekstil - konfeksione". – Individë që janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe janë të aftë të tregojnë aftësi të nivelit 4	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan punën kërkimore për konceptimin dhe ideimin e koleksionit. Përmbajtja: - Përshkrimi i burimeve të ideve për krijimin e koleksionit; - Përzgjedhja e konceptit artistik të koleksionit - Analiza e punës kërkimore për të ideuar koleksionin; - Realizimi i librit të kërkimeve; - Prezantimi i temës dhe historikun e saj - Realizimi i skic - ideve për koleksionin; - Përzgjedhja e siluetës për veshjet e koleksionit; - Përzgjedhja e proporcioneve dhe linjës për veshjet e koleksionit; - Përzgjedhja e detajeve për veshjet e koleksionit; - Përzgjedhja e pëlhurave, ngjyrave dhe teksturës; - Pasqyrimi i ideve nëpërmjet përdorimit të teknikave grafike; - Realizimi i portofolit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Vëzhgimi i procesit të projektimit dhe realizimit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë burime të ndryshme për ideimin e koleksionit; - të përzgjedhë konceptin e koleksionit;	

- të analizojë punën e tij kërkimore për pasurimin e ideve mbi koleksionin;
- të realizojë librin e kërkimeve;
- të prezantojë temën dhe storybordin;
- të realizojë skic idetë për koleksionin;
- të përzgjedhë siluetin e përgjithshëm për veshjet e koleksionit;
- të përzgjedhë proporcionet dhe linjën për veshjet e koleksionit;
- të përzgjedhë detajet për veshjet e koleksionit;
- të përzgjedhë pëlhurat, ngjyrat dhe teksturën;
- të pasqyrojë idetë nëpërmjet përdorimit të teknikave grafike;
- të realizojë portofolin.

RM 2 Nxënësi studion karakteristikat specifike të tekstit në përshtatje me koleksionin e ideuar.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i rëndësisë së karakteristikave të tekstileve në lidhje me siluetin e veshjes;
- Përshkrimi i fibrave natyrale dhe zhvillimet e tyre;
- Përshkrimi i fibrave të prodhuara nga njeriu dhe zhvillimet e tyre;
- Përshkrimi i karakteristikave të endjes dhe mundësitë e përdorimit të tyre në dizenjimin dhe ndërtimin e veshjes;
- Trajtimi i sipërfaqes së tekstileve;
- Dizenjimi dhe printimi i tekstileve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi i procesit të projektimit dhe realizimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rëndësinë që kanë karakteristikat e tekstileve në lidhje me siluetin e veshjes;
- të përshkruajë fibrat natyrale dhe zhvillimet e tyre;
- të përshkruajë fibrat sintetike dhe zhvillimet e tyre;
- të përshkruajë karakteristikat e endjes dhe mundësitë e përdorimit të tyre në dizenjimin dhe ndërtimin e veshjes;
- të eksperimentojë me trajtimin e sipërfaqes së tekstileve;
- të dizenjojnë dhe printojnë tekstile.

RM 3 Nxënësi i jep formë tekstit dy dimensional në veshjen tre dimensionale nëpërmjet teknikave të prerjes dhe modelimit.

Përmbajtja:

- Përgatitja e mjeteve të punës dhe makinerive;
- Përdorimi i teknikave të prerjes dhe modelimit të veshjeve;
- Përdorimi i teknikës së modelimit në manekinë;
- Ndërtimi i formës tredimensionale të veshjes nëpërmjet teknikave të qepjes;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi i procesit të projektimit dhe realizimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë mjetet e punës dhe makineritë;
- të përdorë teknikat e prerjes dhe modelimit të veshjeve;
- të përdorë teknikat e modelimit në manekinë;
- të ndërtojë formën tredimensionale të veshjes nëpërmjet teknikave të qepjes;

RM 4 Nxënësi zhvillon koleksionin sipas grupit të synuar dhe linjave të veshjeve.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i karakteristikave të niveleve të industrisë krijuese: haute couture, prêt à porter, markat e luksit, markat me nivel të mesëm, fast fashion, markat kazual dhe sportive, etj.
- Përshkrimi i linjave të veshjeve sipas gjinisë (femra, meshkuj) dhe moshës.
- Përshkrimi i llojeve të veshjeve: veshje kazuale, xhinset, rrobat e banjës, veshjet intime, veshjet e mbrëmjes, veshjet për raste të veçanta, etj.
- Bashkimi i të gjithë elementëve të koleksionit;
- Prezantimi i koleksionit;
- Përshkrimi i organizimit të sfilatës, panairit, shoë room, etj;
- Promovimi i koleksionit;
- Përshkrimi i elementëve përbërës të brendit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi i procesit të projektimit dhe realizimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë karakteristikat e niveleve të industrisë krijuese: Haute couture, pret-a-porter, brendet e luksit, brendet me nivel të mesëm, brendet kazual dhe sportive, etj;
- të përshkruajë linjat e veshjeve sipas gjinisë: veshje për femra, veshje për meshkuj, veshje për fëmijë
- të përshkruajë llojet e veshjeve: veshje kazuale, xhinset, rrobat e banjës, veshjet intime, veshjet e mbrëmjes, veshjet shoë, etj.
- të bashkojë të gjithë elementët e koleksionit;
- të prezantojë i koleksionin;
- të përshkruajë organizimit të sfilatës, panairit, shoë room, etj;
- të promovojë koleksionin;
- të përshkruajë i elementëve përbërës të markës.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.	Ky modul duhet të trajtohet në klasë si dhe në laboratorin e projektimit dhe të eksperimentimit. - Mësuesi i projektit duhet të demostrojë të gjitha njohuritë dhe hallkat e e çdo procesi të projektimit të koleksionit më vete dhe lidhjen zinxhir të tyre për të siguruar një proces të sukseshëm. - Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete, për kryerjen kërkimit, ideimit, dizenjimit, realizimit dhe reklamimit të koleksionit. - Mësuesi duhet të orientojë punën individuale dhe atë në grup ku Nxënësit shkëmbejnë eksperincat e tyre. - Gjatë vlerësimit të nxënësve, të vihet theksi në arritjet e shprehive dhe aftësive praktike të tyre në procesin e përcaktimit të parametrave të ndryshëm.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të punohet në klasë dhe praktikisht në laboratorin e projektit dhe atë të eksperimentit të paisura me mjetet e punës të nevojshme. - Klasa e pajisur me kompjuter e projektor. - Laboratori i projektit dhe ai eksperimental. - Mjetet e punës artistike, të prerjes, qepjes, etj. - Materiale fotografike, leksione të përgatitura nga mësuesi, udhëzues, katalogë, etj, në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

10. Moduli "Historia e modës"

Profili: Dizenjim mode

Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HISTORIA E MODËS	M-10-1078-14
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i njeh nxënësit me zhvillimin historik dhe social - kulturor të veshjes dhe ndikimin e këtyre aspekteve në modë.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; - Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm. - Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin "Tekstil - konfeksione". - Individë që janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe janë të aftë të tregojnë aftësi të nivelit 4.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan karakteristikat e veshjes që nga kulturat primitive e deri në periudhën bizantine. Përmbajtja: - Përshkrimi i veshjes përpara lindjes së qytetërimeve; - Përshkrimi i veshjes të qytetërimeve në Mesopotami; - Përshkrimi i karakteristikave të veshjes në Egjipt; - Përshkrimi i karakteristikave të veshjes së qytetërimeve semitike; - Përshkrimi i karakteristikave të veshjes në qytetërimet Mede dhe Perse; - Përshkrimi i karakteristikave të veshjes në qytetërimet Minoike dhe Mikenase; - Përshkrimi i karakteristikave të veshjes në qytetërimin grek; - Përshkrimi i karakteristikave të veshjeve në qytetërimet italike (Etruskët dhe Romakët); - Përshkrimi i karakteristikave të veshjeve në periudhën që fillon me rënien e perandorisë Romake dhe përfundon me perandorinë Bizantine. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë të: - të përshkruajë veshjen përpara lindjes së qytetërimeve; - të përshkruajë veshjen e qytetërimeve në Mesopotami; - të përshkruajë karakteristikat e veshjeve egjiptiane; - të përshkruajë karakteristikat e veshjeve të qytetërimeve	

-
- semitike;
- të përshkruajë karakteristikat e veshjeve në qytetërimet e Medëve dhe Persianëve;
 - të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në qytetërimet Minoike dhe Mikenase;
 - të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në qytetërimin Grek;
 - të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në qytetërimet italiane (Etruskët dhe Romakët);
 - të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në periudhën që fillon me rënien e perandorisë Romake dhe përfundon me perandorinë Bizantine.

RM2 Nxënësi përshkruan karakteristikat e veshjes që nga oborret e mesjetës e deri në fund të shekullit XVI – të.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i faktorëve historikë dhe i karakteristikave të veshjeve në periudhën e oborreve të mesjetës;
- Përshkrimi i faktorëve historikë dhe i karakteristikave të veshjeve në shekullin XI deri në shekullin XII në Europë;
- Përshkrimi i faktorëve historikë dhe karakteristikave të veshjeve në shekullin XIII deri në shekullin XIV në Europë;
- Përshkrimi i faktorëve historikë dhe karakteristikave të veshjeve në periudhën e Rilindjes Europiane;
- Përshkrimi i faktorëve historik dhe karakteristikave të veshjeve në shekullin XVI në Europë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në periudhën e oborreve të mesjetës;
- të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në shekullin XI deri në shekullin XII në Europë;
- të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në shekullin XIII deri në shekullin XIV në Europë;
- të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në periudhën e Rilindjes Europiane;
- të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në shekullin XVI në Europë.

RM 3 Nxënësi përshkruan karakteristikat e veshjes që nga mbretëria e Mbretit Diell e deri në fillimet e periudhës Impero.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i faktorëve historik dhe karakteristikave të veshjeve në shekullin XVII në Europë.
- Përshkrimi i faktorëve historik dhe karakteristikave të

- veshjeve në periudhën e Luigjit të XIV;
- Përshkrimi i faktorëve historik dhe karakteristikave të veshjeve në periudhën e Luigjit të XV;
- Përshkrimi i faktorëve historik dhe karakteristikave të veshjeve në shekullin e XVIII në Europë dhe në periudhën e Luigjit XVI;
- Përshkrimi i faktorëve historikë dhe karakteristikave të veshjeve në periudhën e Revolucionit Francez;
- Përshkrimi i faktorëve historikë dhe karakteristikave të veshjeve në fillimet e periudhës Impero;
- Përshkrimi karakteristikave të stilit Dandy;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në shekullin XVII në Europë.
- të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në periudhën e Luigjit të XIV;
- të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në periudhën e Luigjit të XV;
- të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në shekullin e XVIII në Europë dhe në periudhën e Luigjit XVI;
- të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në periudhën e Revolucionit Francez;
- të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në fillimet e periudhës Impero;
- të përshkruajë karakteristikat e stilit Dandy;

RM 4 Nxënësi përshkruan karakteristikat e veshjes që nga periudha Impero e deri te futurizmi.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i faktorëve historik dhe karakteristikave të veshjeve në periudhën e konsoliduar Impero;
- Përshkrimi i faktorëve historik dhe karakteristikave të veshjeve në periudhën e Romantizmit;
- Përshkrimi i lindjes së Modës së Lartë ose “couture tout court”;
- Përshkrimi i zhvillimit të formës së kafazit të fundit në veshjen femërore dhe ndikimet e tij në siluetën e figurës femërore;
- Përshkrimi i faktorëve historikë dhe karakteristikave të veshjeve në periudhën e “Belle Epoque”;
- Përshkrimi i krijimit të një mode revolucionare për femra në Paris në vitet 1900;
- Përshkrimi i mënyrës së përhapjes së modës dhe fenomeni i magazinave të mëdha;
- Përshkrimi i modës gjatë periudhës së luftës së parë botërore;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në periudhën e konsoliduar Impero;
- të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në periudhën e Romantizmit;
- të përshkruajë lindjen e Modës së Lartë ose “couture tout court”;
- të përshkruajë zhvillimin e formës së kafazit të fundit (zhupon) në veshjen femërore dhe ndikimet e tij në siluetin e figurës femërore;
- të përshkruajë faktorët historik dhe karakteristikat e veshjeve në periudhën e “Belle Epoque”;
- të përshkruajë krijimin e modës revolucionare për femra në Paris në vitet 1900;
- të përshkruajë mënyrën e përhapjes së modës dhe fenomenin e magazinave të mëdha;
- të përshkruajë modën gjatë periudhës së luftës së parë botërore;

RM 5 Nxënësi përshkruan karakteristikat e veshjes pas luftës së parë botërore e deri në ditët e sotme.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i karakteristikave të modës në vitet 20;
- Përshkrimi i karakteristikave të modës në vitet 30;
- Përshkrimi i karakteristikave të modës në vitet 40;
- Përshkrimi i karakteristikave të modës në vitet 50;
- Përshkrimi i karakteristikave të modës në vitet 60;
- Përshkrimi i karakteristikave të modës në vitet 70;
- Përshkrimi i fenomenit të “kundërmodës”;
- Përshkrimi i karakteristikave të modës në vitet 80;
- Përshkrimi i karakteristikave të modës në vitet 90;
- Përshkrimi i karakteristikave të modës sot;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë karakteristikat e modës në vitet 20;
- të përshkruajë karakteristikat e modës në vitet 30;
- të përshkruajë karakteristikat e modës në vitet 40;
- të përshkruajë karakteristikat e modës në vitet 50;
- të përshkruajë karakteristikat e modës në vitet 60;
- të përshkruajë karakteristikat e modës në vitet 70;
- të përshkruajë fenomenin e “kundërmodës”;
- të përshkruajë karakteristikat e modës në vitet 80;
- të përshkruajë karakteristikat e modës në vitet 90;
- të përshkruajë karakteristikat e modës sot.

RM 6 Nxënësi përshkruan karakteristikat e veshjeve tradicionale të vendeve të ndryshme të botës dhe ato Shqiptare.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i karakteristikave të veshjeve popullore tradicionale dhe dallimin e tyre nga veshjet e modës;
- Përshkrimi i karakteristikave të veshjeve tradicionale Afrikane, Meksikane, Indiane, Kineze, Japoneze, etj.
- Përshkrimi i historikut të veshjeve tradicionale Shqiptare;
- Përshkrimi i karakteristikave të veshjeve popullore dhe qytetare tradicionale Shqiptare.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë karakteristikat e veshjeve popullore tradicionale dhe dallimin e tyre nga veshjet e modës;
- të përshkruajë karakteristikat e veshjeve tradicionale Afrikane, Meksikane, Indiane, Kineze, Japoneze, etj.
- të përshkruajë historikun e veshjeve tradicionale Shqiptare;
- të përshkruajë karakteristikat e veshjeve popullore dhe qytetare tradicionale Shqiptare.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.	Ky modul duhet të trajtohet në klasë. - Lektori duhet të zhvillojë leksionet duke përdorur sa më shumë materiale ilustruese e fotografike. - Nxënësi duhet të angazhohet në punën kërkimore të gjetjes së materialeve shtesë mbi historinë e modës dhe analizën e tyre. - Gjatë vlerësimit të nxënësve, të vihet theksi në analizën e karakteristikave të veshjeve të periudhave të ndryshme historike.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Realizimi i këtij moduli mundësohet në ambjentet e klasës. Për realizimin me sukses të këtij moduli janë të rëndësishme: - Kompjuteri dhe projektori. - Leksione, fotografi dhe materiale të tjera ilustruese, katalogë, në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

11. Moduli "Teknologji tekstili"

Drejtimi: Dizenjim mode
Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	TEKNOLOGJI TEKSTILI	M-10-1079-14
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit të njohin lëndën e parë fibrat tekstile, mënyrën e identifikimit dhe përpunimit të tyre për realizimin e tekstilit.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	– Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; – Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm. – Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin "Tekstil - konfeksione". – Individë që janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe janë të aftë të tregojnë aftësi të nivelit 4	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Nxënësi përshkruan karakteristikat dhe veçoritë e fibrave tekstile si dhe identifikon fibrat tekstile. Përmbajtja: - Paraqitja e zhvillimit historik të fibrave dhe prodhimit të tekstileve. - Përshkrimi i përgjithshëm mbi fibrat tekstile. - Përcaktimi i klasifikimit të fibrave në bazë të natyrës të prejardhjes së tyre (fibra natyrore dhe fibra të prodhuara nga njeriu). - Listimi i përfaqësuesve kryesorë. - Përshkrimi i fibrave natyrore me origjinë bimore (pambuku, linoja). - Përcaktimi i karakteristikave dhe vetive të fibrës së pambukut. - Përcaktimi i karakteristikave dhe vetive të fibrës së linosë. - Identifikimi i fibrës së pambukut, linosë në mënyrë organoleptike (prova në mikroskop, prova e djegies , prova e tretjes). - Listimi i fibrave të tjera natyrore me origjinë bimore (fibra e sizalit, kanapës, jutës, kërpit, kënafit, kokosit etj). - Përcaktimi i karakteristikave të fibrave natyrore me origjinë shtazore. - Përshkrimi i strukturës së fibrave të marra nga flokët e kafshëve. - Përcaktimi i karakteristikave dhe vetive të fibrës së leshit. - Identifikimi i fibrës së leshit në mënyrë organoleptike

-
- (prova në mikroskop, prova e djegies, prova e tretjes).
- Përcaktimi i karakteristikave dhe vetive të fibrës së mëndafshit.
 - Identifikimi i fibrës së mëndafshit në mënyrë organoleptike (prova në mikroskop, prova e djegies, prova e tretjes).
 - Shpjegimi i karakteristikave të fibrave të tjera natyrore me origjinë shtazore.
 - Përcaktimi i karakteristikave dhe vetive të fibrës së, kashmirit, alpakës, devesë, angorës etj.
 - Listimi i klasifikimit të fibrave artificiale kimike.
 - Shpjegimi i rëndësisë të fibrave artificiale kimike.
 - Radhitja sipas rëndësisë të përfaqësuesve kryesorë të fibrave artificiale.
 - Përcaktimi i karakteristikave të fibrës artificiale kimike – viskoza (rayon).
 - Përcaktimi i karakteristikave dhe vetive të fibrës së acetatit, treacetatit, kupros etj.
 - Identifikimi i fibrës së viskozës dhe modalit në mënyrë organoleptike (prova në mikroskop, prova e djegies, prova e tretjes).
 - Identifikimi i fibrës së acetatit, treacetatit në mënyrë organoleptike (prova në mikroskop, prova e djegies, prova e tretjes).
 - Përdorimi i fibrave artificiale kimike për konfeksion dhe qëllime speciale në sektorin e industrisë së veshjes.
 - Përshkrimi i rëndësisë së fibrave sintetike kimike.
 - Përcaktimi i karakteristikave dhe vetive të fibrave sintetike kimike.
 - Përcaktimi i karakteristikave dhe vecorive të fibrës së akrilikut.
 - Identifikimi i fibrës së akrilikut në mënyrë organoleptike (prova në mikroskop, prova e djegies, prova e tretjes).
 - Përcaktimi i karakteristikave dhe vecorive të fibrës së poliamidit.
 - Identifikimi i fibrës së poliamidit në mënyrë organoleptike (prova në mikroskop, prova e djegies, prova e tretjes).
 - Radhitja e përfitimeve që merren nga përzjerja e fibrave tekstile.
 - Shpjegimi i raportit të përzjerjes së fibrave tekstile për veshje.
 - Përshkrimi i mirëmbajtjes së tekstileve.
 - Leximi dhe interpretimi i etiketës së larjes, mirëmbajtjes dhe etiketës të përzjerjes të fibrave.
 - Shpjegimi i ligjit të etiketimit të teksileve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Test me shkrim

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë zhvillimin historik të fibrave tekstile.

- të përshkruajë rëndësinë e fibrave natyrore dhe fibrave të prodhuara nga njeriu pas viteve 1850.
- të përshkruajë karakteristikat dhe veçoritë e fibrave natyrore dhe rolin e tyre në industrinë e veshjes.
- të përshkruajë karakteristikat dhe veçoritë e fibrave të prodhuara nga njeriu nëpërmjet sintezës së polimerëve si dhe rolin e tyre në industrinë e veshjes.
- të identifikojë në mënyrë organoleptike disa nga përfaqësuesit kryesor të fibrave natyrore me origjinë bimore.
- të identifikojë në mënyrë organoleptike disa nga përfaqësuesit kryesor të fibrave natyrore me origjinë shtazore.
- të identifikojë në mënyrë organoleptike disa nga përfaqësuesit kryesor të fibrave artificiale kimike.
- të identifikojë në mënyrë organoleptike disa nga përfaqësuesit kryesor të fibrave sintetike kimike.
- të shpjegojë përfitimet dhe avantazhet që merren gjatë procesit të përzjerjes së fibrave

RM 2 Nxënësi përshkruan klasifikimin e tekstileve, procesin e filaturimit dhe përcakton llojet ethurjeve.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i karakteristikave dhe veçorive të tekstileve;
- Përshkrimi i klasifikimit të tekstileve.
- Përcaktimi i karakteristikave dhe veçorive të tekstileve të trikotuara.
- Identifikimi i llojeve tëthurjeve në tekstilet e trikotuara.
- Përcaktimi i karakteristikave dhe veçorive të tekstileve të tezgjahuara.
- Identifikimi i llojeve tëthurjeve në tekstilet e tezgjahuara.
- Shpjegimi i karakteristikave të procesit të endjes
- Përshkrimi i karakteristikave të tekstileve.
- Përcaktimi i karakteristikave dhe veçorive të tekstileve pathurje.
- Përshkrimi i parimeve themelore të fijeve.
- Përcaktimi i karakteristikave të fijeve.
- Përshkrimi i procesit të filaturës.
- Klasifikimi i sistemeve të filaturimit.
- Përshkrimi i sistemit të filaturimit të pambukut.
- Përshkrimi i sistemit të filaturimit të leshit.
- Përshkrimi i karakteristikave të sistemeve të tjera të filaturimit.
- Përcaktimi i karakteristikave dhe veçorive të fijeve.
- Identifikimi i llojeve të dredhjes së fillit (dredhja S dhe Z).
- Përshkrimi i karakteristikave të fijeve fantazi
- Përshkrimi i karakteristikave të fijeve për qepje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Test me shkrim

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë saktë procesin e filaturës dhe llojet e sistemeve.
- të përcaktojë si duhet karakteristikat e pëlhurave.
- të përcaktojë karakteristikat dhe vecoritë e tekstileve të trikotuara.
- Identifikimi i llojeve tëthurjeve në tekstilet e trikotuara.
- të përcaktojë saktë karakteristikat dhe vecoritë e tekstileve të tezgjahuara.
- të identifikojë llojet ethurjeve në tekstilet e trikoturara dhe të tezgjahuara.
- të identifikojë llojet e dredhjes së fillit (dredhja S dhe Z).
- të përcaktojë si duhet karakteristikat e fijeve.

RM 3 Nxënësi përshkruan procesin e fisnikërimit të tekstilit në dizënjim mode.**Përmbajtja:**

- Përshkrimi mbi konceptet e përgjithshme të fisnikërimit të tekstileve.
- Përcaktimi i parimeve themelore të fisnikërimit.
- Rradhitja e proceseve të fisnikërimit (faza përgatitore).
- Përshkrimi i proceseve të përmbarim - ngjyrim (ngjyrim, stampim).
- Përshkrimi i llojeve të makinave për ngjyrim.
- Përshkrimi i llojeve të stampimit (makina stampimi me cilindra dhe me shabllon).
- Përshkrimi i stampimit me planche.
- Përshkrimi i stampimit me shabllon.
- Përshkrimi i stampimit të drejtpërdrejtë.
- Përshkrimi i stampimit me gërryerje.
- Përshkrimi i stampimit rezervë.
- Përshkrimi i stampimit me transferim ose “transfer”.
- Zbatimii stampimit me pigment.
- Zbatimi i stampimit me llustrim.
- Përshkrimi i karakteristikave të trajtimeve të ndërmjetme
- Shpjegimi i procesit të termofiksimit
- Shpjegimi dhe zbatojë i procesit të mercerizimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Test me shkrim

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë saktë proceset e fisnikërimit të tekstileve.
- të shpjegojë mënyrat e tratjtimit të ngjyrës në tekstil.
- të përshkruajë saktë llojet e stampimeve.
- të zbatojë disa lloje stampimesh në tekstil.
- të shpjegojë saktë proceset e ndërmjetme

RM 4 Nxënësi përzgjedh materialin mbi bazën e karakteristikave të lëndës së parë (fibra)për realizimin e koleksionit.

- Listimi i karakteristikave të veshjeve të konfeksionuara.
- Përshkrimi i funksioneve kryesore të veshjes dhe kriteret përmbushëse.
- Përshkrimi i procesit të hekurosjes së tekstilit, mënyrat dhe ndikimi i tij në karakteristikat e pëlhurës.
- Përshkrimi i veçorive të tekstileve sipas përdorimit dhe konceptimit të koleksionit.
- Përshkrimi i veçorive të tekstileve për përdorim në rastet e stampimit dixhital.
- Përcaktimi i përzgjedhjes të materialeve në përputhje me konceptin e koleksionit
- Përcaktimi i përzgjedhjes të dizajnit në përputhje me konceptin e koleksionit.
- Përcaktimi i përzgjedhjes të materialeve mbi bazën e natyrës së fibrës për stampim dixhital.
- Përshkrimi i konceptimit të elementëve inovativë në koleksion bazuar në veçoritë e fibrave dhe strukturën e tekstilit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Test me shkrim

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë funksionet e veshjes.
- të përshkruajë procesin e hekurosjes dhe ndikimin e tij në karakteristikat e tekstilit.
- të përzgjedhë materialet e duhura në përputhje me konceptin e koleksionit
- të përzgjedhë materialet dhe fibrat e duhura për stampim dixhital.
- të realizojë konceptimin e elementëve inovativë në koleksion bazuar në veçoritë e materialeve sipas thurjes dhe fibrave.
- të përshkruajë funksionet e veshjes.
- të përshkruajë procesin e hekurosjes dhe ndikimin e tij në karakteristikat e tekstilit.
- të përzgjedhë materialet e duhura në përputhje me konceptin e koleksionit
- të përzgjedhë materialet dhe fibrat e duhura për stampim dixhital.
- të realizojë konceptimin e elementëve inovativë në koleksion bazuar në veçoritë e materialeve sipas thurjes dhe fibrave.

Udhëzime për zbatimin e modulit	– Ky modul duhet të trajtohet në laboratorët fiziko – mekanik dhe kimik të tekstilit dhe lëkurës për dizenjues mode të pajisur me mostra të materialeve, fibra, mikroskop, reagent kimikë si dhe mjetet ndihmëse dhe aparatura për kryerjen e kësaj veprimtarie. – Mësuesi duhet të bazohet kryesisht në anën praktike të realizimit të këtij moduli sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të përdorimit të shembujve. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. – Ata duhet të vihen në punë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. – Gjatë vlerësimit të Nxënësit duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së anës praktike për vlerësimin organoleptik të fibrave fibrave, strukturës së tekstilit për të përzgjedhur mbi bazën e vlerësimeve dhe testeve materialin në përputhje me koleksionin apo për krijime inovative. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: – Laboratori fiziko – mekanik dhe kimik i tekstilit dhe lëkurës në profilin dizenjim mode. – Fibra, mostra materialeve tekstili, mikroskop , kompjuter, aparatat vlerësimin e parametereve të tekstilit, mjete ndihmëse, reagentë kimik, etj. – Manuale, udhëzues, demostrime video dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. – Bashkëpunim me institucione shtetërore që realizojnë veprimtari në fushën e modës.

12. Moduli “Rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në dizenjim mode “

Profili: Dizenjim Mode
Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	RREGULLAT E SIGURIMIT TEKNIK DHE TË MBROJTJES SË MJEDISIT NË DIZENJIM MODE	M-10-1080-14
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i njeh nxënësit me normat dhe standardet e cilësisë, sigurisë dhe rregullave si dhe zbatimin e tyre gjatë kryerjes së detyrave specifike në mjedisin e punës.	
Kohëzgjatja e modulit	18 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	– Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; – Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm. – Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin “Tekstil - konfeksione”. – Individë që janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe janë të aftë të tregojnë aftësi të nivelit 4	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi zbaton normat e cilësisë dhe të sigurisë gjatë veprimeve në ambjentin e punës. Përmbajtja: - Përshkrimi i rëndësisë dhe përparësitë e normave dhe standardeve të cilësisë në mjedisin e punës. - Shpjegimi i procedurave të sigurta gjatë proceseve të ndryshme. - Përcaktimi i mjeteve të duhura. - Përcaktimi i rregullave mbi shmangien e qëndrimeve jo komode - Listimi i dokumentave që përdoren në operacionet dhe sistemet e cilësisë në mjedisin e punës. - Përshkrimi i tipeve të kontrolleve dhe auditimeve që lidhen me vlerësimin e cilësisë si dhe zbatimin e rregullores në ambjentin punues. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje me gojë dhe me shkrim - Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të shpjegojë rëndësinë dhe përparësitë e normave dhe standardeve të cilësisë në mjedisin e punës;	

- të përshkruajë normat themelore të cilësisë mjedisin e punës;
- të përshkruajë sistemet e cilësisë në veprimtaritë e mjedisin e punës;
- të tregojë rëndësinë e dokumentacionit që përdoret në sistemet e cilësisë të ambjentit;
- të përshkruajë dhe ilustrojë rregullat dhe masat që duhen marrë në një mjedis pune.

RM 2 Nxënësi përshkruan rregullat e sigurisë për shmangien e rreziqeve në mjedisin e punës.

Përmbajtja:

- Renditja e rreziqeve dhe shkaqeve gjatë punës në mjedisin e punës
- Përshkrimi i dëmtimeve si pasojë e kushteve fizike jo të përshtatshme në laborator
- Zbatimi i rregullave dhe standardeve të sigurisë në mjedisin e punës
- Përshkrimi i mjediseve të laboratorit kimik dhe rreziqet e mundshme.
- Zbatimi i teknikave të shmangies së rreziqeve mekanike, fizike, kimike, biologjike, ergonomike dhe psikologjike.
- Përshkrimi i përfundimit të rreziqeve mekanike në laboratorin e projektimit të veshjeve
- Ilustrime të pozicionimeve jo të sakta në makineri
- Përshkrimi i mënyrave të transportimit të veshjeve
- Shpjegimi i mënyrave të magazinimit.
- Përshkrimi i rreziqeve fizike (dritat, energjinë elektrike, temperaturën, lëndimet dhe rrezatimet zhurmat, dritdhjet)
- Zbatimi i rregullave ndaj rreziqeve kimike të mundshme nga përzjerja e reagentëve kimik në përcaktimin e përbërjes
- së tekstilit në laboratorin kimik të tekstilit
- Përshkrimet e rreziqeve kimike të përfuara nga pluhurat, tymrat, avujt, materialet toksike, mbeturinat dhe zjarret
- Përshkrimet e rreziqeve biologjike (bakteriet dhe viruset)
- Përshkrimet e rreziqeve ergonomike: ulja, qëndrimi në këmbë dhe tërheqjet
- Përshkrimet e rreziqeve psikologjike (cilësia e punës dhe stresi)
- Planifikimi veprimeve në raste rreziku.
- Përcaktimi i pajisjet dhe mjeteve për mbrojtje individuale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë ose me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rreziqet dhe shkaqet e rreziqeve gjatë punës në laborator.

- të zbatojë rregullat dhe standardet e sigurisë në laborator.
- të përshkruajë mjediset e laboratorit dhe rreziqet përkatëse.
- të përshkruajë rreziqet mekanike, fizike, kimike, biologjike, ergonomike dhe psikologjike, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre.
- të planifikojë veprimet në raste rreziku.
- të përdorë pajisjet dhe mjetet për mbrojtje individuale.

RM 3 Nxënësi zbaton rregullat e kushteve klimatike gjatë veprimtarive në mjedisin e punës

Përmbajtja:

- Përshkrimi i rregullave kryesore për zbatimin e kushteve (ndriçimi, dimensionet e dhomës dhe hapësira e nevojshme, klimatizimi, temperatura, ajrimi) gjatë veprimtarisë në laborator.
- Pasoja nga moszbatimi i rregullave të kushteve optimale së mjedisit gjatë veprimtarisë në laborator.
- Masat që merren për përshtatjen e mjedisit gjatë veprimtarisë në laborator.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë ose me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rëndësinë e kushteve optimale (ndricim, dimensionet e dhomës, hapësirën e nevojshme dhe ventilimin për mbarëvajtjen e proceseve të punës gjatë veprimtarisë në mjedisin punues.
- të shpjegojë rregullat kryesore për mirëmbajtjen e mjedisit gjatë veprimtarisë së tij.
- të zbatojë rregullat kryesore për mbrojtjen e mjedisit gjatë veprimtarisë në laborator
- të përshkruajë pasojat nga mos-zbatimi i rregullave dhe kushteve optimale gjatë veprimtarisë në laborator.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të zhvillohet në mjediset e:
 - Laboratorit të projektimit dhe prodhimit të veshjeve
 - Laboratorit fiziko - mekanik kimik të tekstilit
 - Laboratorit fiziko - kimik të tekstilit
- Mësuesi duhet të japë sa më shumë shembuj dhe ilustrime të koncepteve dhe parametrave të cilësisë, saktësisë dhe sigurisë si dhe të demonstrojë procedura laboratorike në përputhje me këto norma e standarde;
- Nxënësi duhet të angazhohet sa më shumë të jetë e mundur në diskutimet në lidhje me konceptet dhe parametrat e sigurisë, saktësisë dhe cilësisë, me normat dhe standardet përkatëse si dhe të kryejnë procedura laboratorike në përputhje me këto norma e standarde.
- Gjatë vlerësimit të Nxënësit duhet të synohet më tepër në verifikimin e shkallës së aftësive praktike që ata kanë fituar për

	të kryer veprime dhe organizimin efektiv gjatë veprimtarisë në laborator. – Mësuesi duhet të kërkojë me rreptësi zbatimin e normave dhe standardeve të cilësisë dhe të sigurisë. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kriterëve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimin, të pasjitur si më poshtë: – Laborator fiziko- mekanik dhe kimik i tekstilit – Laborator i projektimi dhe prodhimit të veshjeve – Tabela dhe pankarta ilustruese. – Pajisje dhe mjete laboratorike. – Reagentë kimikë dhe materiale të tjera laboratorike. – Dokumente të normave dhe standardeve për veprimet laboratorike. – Rregullore të cilësisë dhe sigurisë në laboratorët fiziko – mekanik dhe kimik. – Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

13. Moduli "Kwadri ligjor në fushën e modës"

Drejtimi: Dizenjim mode
Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	KUADRI LIGJOR NË FUSHËN E MODËS	M-11-072-11
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i aftëson nxënësit për të zotëruar nocionet dhe kuadrin ligjor bazë në fushën e modës.	
Kohëzgjatja e modulit	18 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; - Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm. - Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin "Tekstil - konfeksione". - Individë që janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe janë të aftë të tregojnë aftësi të nivelit 4.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan legjislacionin e Kodit të Punës. Përmbajtja: - Shpjegimi i rolit dhe rëndësisë së Kodit të Punës. - Shpjegimi i dispozitave të përgjithshme të Kodit të Punës. - Shpjegimi i të drejtave themelore si dhe përparësitë e normave të së drejtës. - Shpjegimi i raporteve individuale dhe detyrimet e punëdhënësit. - Përshkrimi i të drejtave dhe mbrojtja e veçantë për gratë dhe të miturit. - Përshkrimi i marrëdhënies në punë, kontratat, pagat, dhe pushimet - Roli i organizatave sindikale (ndërmjetësimi, pajtimi, arbitrimi) Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Test me shkrim Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e Kodit të Punës. - të shpjegojë dispozitat e përgjithshme të Kodit të Punës - të shpjegojë të drejtat themelore si dhe përparësitë e normave të së drejtës . - të shpjegojë raportet individuale dhe detyrimet e punëdhënësit . - të përshkruajë të drejtat dhe mbrojtjen e veçantë për gratë dhe të miturit	

- të përshkruajë marrëdhënien në punë, kontratat, pagat dhe pushimet
- të përshkruajë rolin organizatave sindikale (ndërmjetësimi pajtimi, arbitrimi).

RM 2 Nxënësi përshkruan ligjin për të drejtat e pronësisë intelektuale

Përmbajtja:

- Shpjegimi i rolit dhe rëndësisë së kuadrit ligjor për të drejtat e pronësisë intelektuale
- Renditja e ligjeve për të drejtat e pronësisë intelektuale
- Përkufizimi i ligjeve për të drejtat e pronësisë intelektuale
- Listimi i institucionaleve përgjegjëse për mbrojtjen e pronësisë intelektuale në Shqipëri (DPPM - Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe e Markave ; ZSHDA -Zyra Shqiptare e të Drejtës së Autorit; DPPSH -Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; DPD -Drejtoria e Përgjithshme e Doganave).
- Shpjegimi i misionit dhe vizionit të tyre në rolin e mbrojtjes së pronësisë intelektuale

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e kuadrit ligjor për të drejtat e pronësisë intelektuale.
- të kryejë renditjen e ligjeve për të drejtat e intelektuale
- të përshkruajë përkufizimin e ligjeve për të drejtat e pronësisë intelektuale
- të listojë institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e pronësisë intelektuale në Shqipëri
- të shpjegojë misionin dhe vizionin e tyre në rolin e mbrojtjes së pronësisë intelektuale

RM 3 Nxënësi përshkruan ligjin për të drejtën e autorit.

Përmbajtja:

- Shpjegimi i rolit dhe rëndësisë së ligjit “Për të drejtën e autorit”
- Listimi i dispozitave të përgjithshme të kuadrit ligjor në fushën e modës
- Subjekti i ligjit dhe të drejtat që gëzojnë mbrojtje (sanksionet e të drejtave morale dhe ekonomike)
- Pronësia për të drejtën morale për pronën
- Kuptimi i të drejtës së autorit
- Pronësia intelektuale ,e drejta e autorit dhe pronësia industriale me elementët përbërës (vepra origjinale dhe e prejardhur)
- Mbrojtja e të drejtës së autorit nga legjislacioni shqiptar(në aspektin civil,administrativ dhe penal)
- Zyra Shqiptare e të Drejtës së Autorit(ZSHDA) si

institucion që ushtron veprimtarinë në mbështetje të Kushtetutës .

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rolin dhe rëndësinë e ligjit “Për të drejtën e autorit”
- të listojë dispozitat e përgjithshme të kuadrit ligjor në fushën e modës
- të përshkruaj subjektin e ligjit dhe të drejtat që gëzojnë mbrojtje(sanksionet e të drejtave morale dhe ekonomike)
- të përshkruajë pronësinë për të drejtën morale për pronën
- të përshkruajë kuptimin e të drejtës së autorit
- të përshkruajë pronësinë intelektuale ;e drejta e autorit dhe pronësia industriale me elementët përbërës(vepra origjinale dhe e prejardhur)
- të përshkruajë mbrojtjen e të drejtës së autorit nga legjislacioni shqiptar(në aspektin civil,administrativ dhe penal)
- të përshkruajë Zyra Shqiptare e të Drejtës së Autorit (ZSHDA) si institucion që ushtron veprimtarinë në mbështetje të Kushtetutës

RM 4 Nxënësi zbaton ligjin për mbrojtjen e pasurisë industriale, patentat, markat dhe disenjot industriale.

Përmbajtja:

- Shpjegimi i dispozitave të përgjithshme mbi mbrojtjen e pasurisë industriale (patentat, markat, disenjot industrial)
- Shpjegimi për fushën e zbatimit, aplikimin dhe procedurat për dhënien e një patente.
- Shpjegimi i marrëveshjes së Licensimit
- Shpjegimi për disenjot industriale , risitë dhe karakterin individual
- Shpjegimi për markat tregtare dhe ato të shërbimit
- E drejta për prioritet dhe procedurat e regjistrimit të markës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë dispozitat e përgjithshme mbi mbrojtjen e pasurisë industriale (patentat, markat, disenjot industriale)
- të shpjegojë fushën e zbatimit,aplikimin dhe procedurat për dhënien e një patente
- të shpjegojë marreveshjen e licensimit
- të shpjegojë disenjot industriale ,risite dhe karaterin individual
- të shpjegojë markat tregtare dhe të shërbimit
- të përshkruajë të drejtën për prioritet dhe procedurat e

regjistrimit të markës.

Udhëzime për zbatimin e modulit	– Ky modul duhet të trajtohet në klasë. – Mësuesi duhet të demonstrojë praktikisht të gjitha njohuritë dhe hallkat e procesit analitik të masave për zbatimin e së drejtës së autorit, për mbrojtjen e pasurisë industriale, patentat, markat dhe disenjot industriale, për të drejtat e pronësisë intelektuale, etj. – Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete në zbatimin e ligjeve në përputhje me zhvillimin e realiteteve të reja, në aftësimin tyre për jetën. – Mësuesi duhet të organizojë punën me metoda të ndryshme mësimdhënieje, ku Nxënësit kryejnë interpretime të ligjeve dhe të standarteve në përputhje me situata konkrete. – Gjatë vlerësimit të nxënësve, të vihet theksi në arritjet e sjelljeve shprehive dhe aftësive të cilat nxësin të menduarit kritik dhe krijues.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme: - Në një klasë - Komplet i ligjeve të së drejtës së autorit, për mbrojtjen e pasurisë industriale, patentat, markat dhe disenjot industriale, për të drejtat e pronësisë intelektuale, kopje e kodit të punës, etj. - Paisje teknologjike që shërbejnë për mësimdhënie. - Manuale, udhëzuesa, katalogë, rregullore standarte në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

14. Moduli “Industria krijuese në fushën e modës”

Profili: Dizenjim mode

Niveli: V i KSHK

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	INDUSTRIA KRIJUESE NË FUSHËN E MODËS	M-10-1082-14
Qëllimi i modulit	Një modul teorik dhe praktik që i njeh nxënësit me mënyrën e funksionimit të industrisë krijuese dhe i aftëson ata të realizojnë nga ana estetike dhe funksionale objekte dizajni të arredimit.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	– Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; – Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm. – Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin “Tekstil - konfeksione”. Individë që janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe janë të aftë të tregojnë aftësi të nivelit 4.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan strukturën ekonomike dhe komerciale të industrisë krijuese. Përmbajtja - Përshkrimi i strukturës ekonomike dhe komerciale i produktit të dizajnit; - Përshkrimi i sektorit të përpunimit të lëndës së parë (materiale të forta dhe të buta)dhe i strukturës prodhuese; - Përshkrimi i analizës dhe zgjedhjes së biznesit; - Përshkrimi i klasifikimit të kërkesës dhe marrja e vendimeve; - Përshkrimi i eksperimenteve dhe projektet mbi porosinë. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Test me shkrim Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë strukturën ekonomike dhe komerciale të produktit të dizajnit; - të përshkruajë sektorët mercologjikë dhe strukturën prodhuese; - të përshkruajë analizën dhe zgjedhjet e biznesit; - të përshkruajë klasifikimin e kërkesës dhe marrjen e vendimeve; - të përshkruajë eksperimentet dhe projektet mbi porosinë	

RM 2 Nxënësi përshkruan lidhjen midis modës, arkitekturës dhe dizenjimit interior

Përmbajtja:

- Përshkrimi i zhvillimit të dizenjimit interior
- Përshkrimi i lidhjes midis modës dhe dizenjimit interior
- Përshkrimi i stileve të dizenjimit interior (neoklasik, barok, rokoko, romantik, bashkëkohor, modern, art-deko, etj)
- Shpjegimi i aspekteve të përbashkëta dhe atyre të ndryshme midis dizenjimit interior dhe arkitekturës
- Përshkrimi i prirjeve të dizenjimit interior
- Përshkrimi i së ardhmes së dizenjimit interior si profesion

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgimi në praktikë i përdorimit të aparatit fotografik

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë zhvillimin e dizenjimit interior
- të përshkruajë lidhjen midis modës dhe dizenjimit interior
- të përshkruajë stilet e dizenjimit interior (neoklasik, barok, rokoko, romantik, bashkëkohor, modern, art-deko, etj)
- të shpjegojë aspektet e përbashkëta dhe ato të ndryshme midis dizenjimit interior dhe arkitekturës
- të përshkruajë prirjet e dizenjimit interior
- të përshkruajë të ardhmen e dizenjimit interior si profesion

RM 3 Nxënësi realizon skicë idetë mbi objekte të ndryshme të arredimit.

Përmbajtja

- Analiza mbi funksionin e elementeve dhe objektit të arredimit
- Përshkrimi i raportit të përmasave dhe funksionit
- Përshkrimi i analizës së materialeve (druri, xhami, tekstilet, metalet, materiale të reja) dhe teknikave në varësi të elementeve dhe të objektit
- Përshkrimi i objektit në lidhje me grupin e synuar
- Realizimi i skicë ideve nëpërmjet teknikave grafike, manuale ose kompjuterike, për disa (dy ose tre) objekte arredimi (karrike, kolltuk, tavolinë, abazhur, jastekë, pasqyrë, etj)
- Realizimi i dy ose tre objekteve të arredimit me materiale të ndryshme

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vlerësim mbi punimin e realizuar.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë funksionin e objektit të arredimit

- të përshkruajë raportin e përmasave dhe funksionit
- të përshkruajë analizën e materialeve (druri, xhami, tekstilet, metalet, materiale të reja) dhe teknikave në varësi të objektit;
- të përshkruajë objektin në lidhje me grupin e synuar
- të realizojë i skicë idetë nëpërmjet teknikave grafike, manuale ose kompjuterike, për disa (dy ose tre) objekte arredimi(karrike, kolltuk, tavolinë, abazhur, jastekë, pasqyrë, etj)
- të realizojë dy ose tre objekteve të arredimit me materiale të ndryshme

RM 4 Nxënësi realizon objekte arredimi duke përdorur materiale të riciklueshme dhe ripërdorimin e objekteve të ndryshme në një kontekst të ri.

Përmbajtja

- Përshkrimi i rëndësisë dhe përdorimit të materialeve të riciklueshme
- Skicimi dhe realizimi i objekteve të arredimit nëpërmjet përdorimit të materialeve të riciklueshme;
- Ndryshimi i funksionit fillestar të objektit në një kontekst të ri në dizajn (mobilje, objekte dekorative, vazo, arka, enë të ndryshme, rafte, etj);
- Eksperimentimi dhe konkurimi me tema të caktuara.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vlerësim mbi punimin e realizuar.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rëndësinë dhe përdorimin e materialeve të riciklueshme
- të skicojë dhe realizojë objekte të arredimit nëpërmjet përdorimit të materialeve të riciklueshme;
- të ndryshojë funksionin fillestar të objektit në një kontekst të ri në dizajn (mobilje, objekte dekorative, vazo, arka, enë të ndryshme, rafte, etj);
- të eksperimentojë dhe konkurojë me tema të caktuara.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të zhvillohet në klasë, në laboratorin e eksperimentit ose edhe në ndërmarrje e artizanë që prodhojnë objekte dizajni. - Lektori duhet të zhvillojë leksionet duke përdorur sa më shumë materiale ilustruese e fotografike. - Nxënësi duhet të angazhohet në punën kërkimore të gjetjes së materialeve shtesë mbi temat mësimore të zhvilluara në modul dhe t'i analizojë ato. - Nxënësi duhet të angazhohet në punën krijuese që nga ideimi e deri te realizimi i objekteve të dizajnit. - Gjatë vlerësimit të nxënësve, të vihet theksi në realizimin e objekteve të dizajnit, në mënyrën e kombinimit të estetikës funksionit dhe mënyrës së përdorimit të materialit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Realizimi i këtij moduli mundësohet në ambjentet e klasës në laboratorin e eksperimentit ose edhe në ndërmarrje e artizanë që prodhojnë objekte dizajni. Për realizimin me sukses të këtij moduli janë të rëndësishme: - Kompjuteri dhe projektori. - Leksione, fotografi dhe materiale të tjera ilustruese, katalogë, në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. - Laboratori eksperimental me materialet e nevojshme.

15. Moduli “Përdorimi i fotografisë në dizënjim mode”.

Profili: Dizënjues mode

Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRDORIMI I FOTOGRAFISË NË DIZENJIM MODE	M-10-1083-14
Qëllimi i modulit	Një modul teorik-praktik që aftëson nxënësit me zotërimin e nocioneve të artit të fotografisë dhe përdorimin e tyre në fushën e modës.	
Kohëzgjatja e modulit	66 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	– Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; – Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm. – Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin “Tekstil - konfeksione”. – Individë që janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe janë të aftë të tregojnë aftësi të nivelit 4.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan aparatën fotografikë dhe mjetet e punës së fotografimit. Përmbajtja: - Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme të aparatit fotografik; - Përshkrimi i parimeve të optikës dhe dhomës së errët; - Shpjegimi i llojeve të aparateve fotografike; - Përshkrimi i llojeve të objektivave; - Përshkrimi i mjeteve të fotografisë në studio; Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim. - Vëzhgimi në praktikë i përdorimit të aparatit fotografik Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë karakteristikat e përgjithshme të aparatit fotografik; - të përshkruajë parimet e optikës dhe dhomës së errët; - të shpjegojë llojet e aparatit fotografik; - të përshkruajë llojet e objektivave; - të përshkruajë mjetet e fotografisë në studio;	
	RM2 Nxënësi analizon elementët kompozicionalë të imazheve fotografike. Përmbajtja: - Përshkrimi i elementëve thelbësorë të një imazhi fotografik;	

- Përshkrimi i ngjyrave dhe kontrastit në fotografi;
- Përshkrimi i fotografisë me tonet e bardhë e zisë;
- Përshkrimi i rëndësisë së dritës për të arritur teksturën në fotografi;
- Përshkrimi i rëndësisë së kompozimit në fotografi;
- Analiza e kompozimit (klasik dhe modern);
- Analiza e pikës së shikimit në fotografi;
- Analiza e planeve të imazheve fotografike
- Analiza e ekuilibrit dhe e proporcioneve në fotografi.
- Përdorimi i aparatit fotografik për të realizuar njohuritë mbi kompozimin.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgimi në praktikë i realizimit të fotografive.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë elementët thelbësorë të një imazhi fotografik;
- të përshkruajë ngjyrat dhe kontrastin në fotografi;
- të përshkruajë tonet e bardhë e zisë në fotografi;
- të përshkruajë rëndësinë e dritës për të arritur teksturën në fotografi;
- të përshkruajë rëndësinë e kompozimit në fotografi;
- të analizojë kompozimin (klasik dhe modern);
- të analizojë pikën e shikimit në fotografi;
- të analizojë planet në imazhet fotografike.
- të analizojë ekuilibrin dhe e proporcionet në fotografi;
- të përdorë aparatit fotografik për të realizuar njohuritë mbi kompozimin.

RM 3 Nxënësi realizon fotografi në gjininë e portretit, të figurës së modës dhe të natyrës së qetë.

Përmbajtja:

- Realizimi i portretit në fotografinë e modës;
- Realizimi i karakterit dhe personalitetit në portretin fotografik;
- Realizimi i portreteve bardhë e zi;
- Përdorimi i dritës natyrale dhe artificiale për realizimin e figurës së njeriut në fotografi (figurës së modës);
- Realizimi i figurës së stilizuar në fotografi;
- Theksimi i lëvizjes në fotografinë e modës;
- Realizimi i natyrës së qetë dhe përdorimi i dritës së duhur.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgimi në praktikë i realizimit të fotografive.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë portretin në fotografinë e modës;
- të realizojë karakterin dhe personalitetin në portretin fotografik;

- të realizojë portretin bardhe e zi;
- të përdorë dritën natyrale dhe artificiale për realizimin e figurës së njeriut në fotografi (figurës së modës);
- të realizojë figurën e stilizuar në fotografi;
- të theksojë lëvizjen në fotografinë e modës;
- të realizojë natyrën e qetë në fotografi.

RM 4 Nxënësi analizon rëndësinë që ka imazhi fotografik në reklamimin e koleksionit.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i mjeteve fotografike që përdoren për përpunimin e imazhit;
- Përdorimi i efekteve speciale në kompjuter
- Përshkrimi i fotografisë së reklamës
- Shpjegimi i raportit agjensi-fotograf
- Përshkrimi i prirjeve të fotografisë bashkohore të modës

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgimi në praktikë i realizimit të fotografive.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë mjetet fotografike që përdoren për përpunimin e imazhit;
- të përdorë efektet speciale në kompjuter;
- të përshkruajë fotografinë e reklamës;
- të shpjegojë raportin agjensi-fotograf;
- të përshkruajë prirjet e fotografisë bashkohore të modës.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë, në laborator dhe jashtë tij.
- Mësuesi duhet të demonstrojë praktikisht të gjitha njohuritë dhe hallkat e procesit teknik dhe artistik të realizimit të fotografisë së modës.
- Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete në realizimin e fotografive në situata të ndryshme artistike.
- Mësuesi duhet të organizojë punën me metoda të ndryshme mësim nxënie, ku Nxënësit kryejnë interpretime të imazheve fotografike në përputhje me situata konkrete.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, të vihet theksi në arritjet e shprehive të cilat nxisin të menduarit kritik dhe krijues.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të punohet praktikisht dhe të sigurohen mjediset, mjete dhe materialet e mëposhtme:
- Në një studio profesionale fotografie ose në një hapësirë të laboratorit të përshtatur si studio.
 - Aparat fotografik dhe paisje teknologjike.
 - Udhëzuesa, katalogë, materiale ndihmëse në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

16. Moduli "Psikologjia sociale e veshjes".

Profili: Dizenjim mode

Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PSIKOLOGJIA SOCIALE E VESHJES	M-10-1084-14
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i njeh nxënësit me rolin komunikues të veshjes në shoqërinë njerëzore, si dhe i ndihmon ata të realizojnë një koleksion të suksesshëm në biznesin e modës.	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; - Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; - Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm. - Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin "Tekstil - konfeksione". - Individë që janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe janë të aftë të tregojnë aftësi të nivelit 4.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan psikologjinë sociale të veshjes. Përmbajtja - Përshkrimi i funksioneve të veshjes (utilitar dhe komunikues); - Përshkrimi i objektit të studimit të psikologjisë sociale dhe i rëndësisë së studimit të psikologjisë sociale të veshjes; - Përshkrimi i mënyrës se si veshja influencon përshtypjet dhe sjelljet e të tjerëve; - Përshkrimi i mënyrës se si veshja ndikon mbi vetë perceptimin dhe sjelljen tonë; - Përshkrimi i mënyrës se si influencohemi nga veshja e të tjerëve; Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Test me shkrim Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë funksionet e veshjes (utilitar dhe komunikues) - të përshkruajë objektin e studimit të psikologjisë sociale dhe rëndësinë e studimit të psikologjisë sociale të veshjes; - të përshkruajë mënyrën se si veshja influencon përshtypjet dhe sjelljen e të tjerëve; - të përshkruajë mënyrën se si veshja ndikon mbi vetë	

-
- perceptimin dhe sjelljen tonë;
 - të përshkruajë mënyrën se si influencohemi nga veshja e të tjerëve;

RM2 Nxënësi përshkruan lidhjen e ngushtë të veshjes (forma,ngjyra,linja,aksesorët,tradita,etj) me identitetin.

Përmbajtja

- Përshkrimi i kontekstit kulturor të veshjes;
- Përshkrimi veshjes sipas gjinisë;
- Përshkrimi veshjes sipas moshës;
- Përshkrimi i veshjes sipas klasës sociale;
- Përshkrimi i veshjes sipas profilit të punës;
- Përshkrimi veshjes sipas zonave gjeografike dhe sezonit;
- Përshkrimi veshjes së përditshme dhe për raste;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Test me shkrim

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë kontekstin kulturor të veshjes
- të përshkruajë veshjen sipas gjinisë
- të përshkruajë veshjen sipas moshës
- të përshkruajë veshjen sipas klasës sociale
- të përshkruajë veshjen sipas profilit të punës
- të përshkruajë veshjen sipas zonave gjeografike dhe sezonit
- të përshkruajë veshjen e përditshme dhe për raste

RM 3 Nxënësi përshkruan faktorët psikologjikë që ndikojnë në veshjen ose stilin personal.

Përmbajtja

- Përshkrimi i veshjeve si një qëndrim i njerëzve ndaj vetes dhe shoqërisë që i përkasin (rebel apo konform rregullave);
- Shpjegimi i përdorimit të veshjes si një mundësi për të ndyshuar gjëndjen (shpirtërore, sociale, etj) aktuale;
- Përshkrimi i përdorimit të veshjes si një mjet për të rënë në sy dhe për të bërë tërheqës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Test me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë veshjet si një qëndrim i njerëzve ndaj vetes dhe shoqërisë që i përkasin (rebel apo konform rregullave)
- të shpjegojë përdorimin e veshjes si një mundësi për të ndyshuar gjëndjen (shpirtërore, sociale, etj) aktuale
- të përshkruajë përdorimin e veshjes si një mjet për të rënë në sy dhe për të bërë tërheqës.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.	Ky modul duhet të trajtohet në klasë. - Mësuesi duhet të zhvillojë leksionet duke përdorur sa më shumë materiale ilustruese e fotografike. - Nxënësi duhet të angazhohet në punën kërkimore të gjetjes së materialeve shitesë mbi temat mësimore të zhvilluara në modul dhe t'i analizojë ato. - Gjatë vlerësimit të nxënësve, të vihet theksi në analizën e karakteristikave të veshjeve dhe rolin komunikues të saj në shoqëri.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Realizimi i këtij moduli mundësohet në klasë. Për realizimin me sukses të këtij moduli janë të rëndësishme: - Kompjuteri dhe projektori. - Leksione, fotografi dhe materiale të tjera ilustruese, katalogë, në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

17. Moduli “Menaxhimi në biznesin e modës”

Profili: Dizenjim mode

Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MENAXHIMI NË BIZNESIN E MODËS	M-10-1085-14
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko – praktik që synon ti’ japë nxënësit njohuritë e nevojshme në lidhje me menaxhimin e punës, prodhimit dhe operacioneve në biznesin e modës si dhe zbatimin e tyre në praktikë.	
Kohëzgjatja e modulit	42 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	– Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore; – Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm. – Individë që kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale në drejtimin “Tekstil - konfeksione”. – Individë që janë të punësuar në industrinë e veshjeve dhe janë të aftë të tregojnë aftësi të nivelit 4.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan funksionet dhe rolin e menaxherit si dhe përcaktimet e operacioneve të prodhimit Përmbajtja: - Përshkrimi i historikut të menaxhimit dhe evoluimi i tij. - Shpjegimi i koncepteve dhe përkufizime në lidhje me menaxhimin e prodhimit dhe operacioneve. - Listimi i funksioneve dhe rolet e menaxherit. - Përcaktimi i kompetencave - rezultat i koordinimit. - Zbatimi i menaxhimit të operacioneve. - Përmbushja e kriterëve të vlerësimit të performancës së funksionit të operacioneve. - Shpjegimi i projektimit në menaxhimin e operacioneve - Përcaktimi i faktorëve të projektimit. - Përzgjedhja e procesit lidhur me projektimin e një produkti dhe kapacitetin e tij. - Listimi i proceseve të prodhimit dhe shërbimit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim - Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë historikun e menaxhimit dhe evoluimin e tij. - të shpjegojë koncepte dhe përkufizime në lidhje me menaxhimin e prodhimit dhe operacioneve.	

-
- të listojë funksionet dhe rolet e menaxherit.
 - të përcaktojë kompetencat si rezultat i koordinimit.
 - të zbatojë menaxhimin e operacioneve.
 - të përmbushë kriteret e vlerësimit të performancës së të funksionit të operacioneve.
 - të shpjegojë projektimin në menaxhimin e operacioneve
 - të përcaktojë faktorët e projektimit.
 - të për zgjedhë procesin lidhur me projektimin e një produkti dhe kapacitetin e tij.
 - të listojë proceset e prodhimit dhe shërbimit.

RM 2 Nxënësi përshkruan strategjitë e shitjes me pakicë të markave të ndryshme dhe mënyrën e planifikimit për nxjerrjen e produkteve të reja në treg.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i menaxhimit të shitjes me pakicë.
- Shpjegimi i qëllimit të menaxhimit të produkteve me pakicë.
- Përcaktimi i strategjisë të shitjes me pakicë.
- Studimi i strategjisë “Porter”.
- Përzgjedhja dhe planifikimi i gamës së produkteve.
- Përshkrimi i menaxhimit operacional i produktit brenda tregut.
- Përshkrimi i procesit të menaxhimit të produkteve me pakicë nga konceptimi tek shpërndarja.
- Listimi i shumëllojshmërisë së produkteve (lista e modeleve rezervë).
- Shpjegimi i mënyrave të paketimit.
- Përcaktimi i dobive.
- Përcaktimi i cilësisë së produkteve.
- Përshkrimi i sigurimit të cilësisë së produkteve.
- Zbatimi i mënyrave të kontrollit të cilësisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë menaxhimin e shitjes me pakicë.
- të shpjegojë qëllimin e menaxhimit të produkteve me pakicë.
- të përcaktojë strategjinë e shitjes me pakicë.
- të studiojë strategjinë “Porter”.
- të për zgjedhë dhe planifikojë gamën e produkteve.
- të përshkruajë menaxhimin operacional të produktit brenda tregut.
- të përshkruajë procesin e menaxhimit të produkteve me pakicë nga konceptimi tek shpërndarja.
- të listojë shumëllojshmërinë e produkteve (lista e modeleve rezervë).

- të shpjegojë mënyrat e paketimit.
- të përcaktojë dobitë.
- të përcaktojë cilësinë e produkteve.
- të përshkruajë sigurimin e cilësisë së produkteve.
- të zbatojë mënyrat e kontrollit të cilësisë.

RM 3 Nxënësi përshkruan mënyrën e organizimit të punës në biznesin e modës dhe zbaton metodat e matjes së punës për një produkt të caktuar.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i vendimeve mbi sasinë e prodhimit dhe menaxhimit të rezervave.
- Përshkrimi i sasisë ekonomike të porositur (EOQ).
- Përshkrimi i nivelit të shërbimit.
- Listimi i shumëllojshmërisë së kërkesave.
- Përshkrimi i avantazhit konkurrues të një projektimi të mirë.
- Shpjegimi i konceptit të projektimit të punës dhe matja e saj.
- Përshkrimi i drejtimit shkencor të punës, masa e specializimit të punës.
- Shpjegimi i metodave të matjes së punës; kurba e eksperiencës.
- Listimi i procedurave për përmirësimin e performancës së punonjësve.
- Shpjegimi i sistemeve të menaxhimit të cilësisë.
- Përcaktimi i qëllimeve dhe normativave.
- Listimi i përgjegjësive manaxheriale.
- Realizimi i një produkti të mirëpërcaktuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë vendimet mbi sasinë e prodhimit dhe menaxhimit të rezervave.
- të përshkruajë sasinë ekonomike të porositur (EOQ).
- të përshkruajë nivelin e shërbimit.
- të listojë shumëllojshmërinë e kërkesave.
- të përshkruajë avantazhin konkurrues të një projektimi të mirë.
- të shpjegojë konceptin e projektimit të punës dhe matjes së saj.
- të përshkruajë drejtimin shkencor të punës dhe masën e specializimit të saj.
- të shpjegojë metodat e matjes së punës dhe kurbën e eksperiencës.
- të listojë procedurat për përmirësimin e performancës së punonjësve.

- të shpjegojë sistemet e menaxhimit të cilësisë.
- të përcaktojë qëllimet dhe normativat.
- të listojë përgjegjësitë manaxheriale.
- të realizojë një produkt të mirëpërcakuar.

**Udhëzime për
zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale të një biznesi mode.
- Mësuesi praktikës duhet të demonstrojë praktikisht të gjitha njohuritë dhe hallkat e procesit të menaxherit dhe funksionet e tij.
- Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete, për për llogaritje të kostove si dhe llogaritjen e kohës për operacione të vecanta.
- Gjatë vlerësimit të Nxënësit, duhet të vihet theksi në arritjet e shprehive dhe aftësive praktike të tyre në kryerjen e një funksioni nmenaxherial.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise laboratorike të përshtatshme për zhvillimin e analizave bazë mikrobiologjike si dhe materiale ndihmëse si më poshtë:
- Mjetet për matjen e kohës së punës në operacione të ndryshme.
 - Kompjuter, printer, fotokopje, shërbim interneti për të realizuar përmbajtjen e modulit.
 - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Bashkëpunim me atelierë mode për realizimin e anës praktike të këtij moduli.
 - Laborator prodhimi veshjesh ose bashkëpunim në industrinë e veshjeve.
-